



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 12 MARS 2015**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 12. MARTA 2015. GODINE**

**MARS - MART
2015**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2015,
5. Zgjedhja e nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës nga radha e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”,
6. Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Razmatranje zahteva Fonda penzijskih štednji Kosova za usvajanje godišnjih taksi za 2015. godinu,
5. Izbor potpredsednika Skupštine Kosova iz redova Parlamentarne grupe pokreta “Vetëvendosje”,
6. Izbor dva (2) člana Nezavisne komisije za medije.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Të nderuar deputetë,
Ju njoftoj se deputeti Blerim Shala, në bazë të nenit 20, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, më ka njoftuar me shkrim se nga data 2 mars 2015 e ka lëshuar Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, ndërsa veprimtarinë e tij parlamentare në të ardhmen do ta vazhdojë si deputet i pavarur, pra pa grup parlamentar.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre minuta.

Janë të lajmëruar gjithsej 20 diskutues për pikën e parë të rendit të ditës. Atëherë deputetja Melihate Tërmkolli e ka fjalën.

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,
Kryetari mund të më thërrasë veç në emër, s'ka lidhje, asnjë problem i kësaj natyre.

Unë dola këtu absolutisht për asnjë lloj arsytimi, por më tepër për një lloj sqarimi, meqë dikush po përpiqet t'i japë një konotacion dhe një kahje tjetër. Dje, sidomos, plot media kanë bërë zhurmë, në fakt nuk është problemi i mediave, se tjetërkush ka bërë zhurmë, por po fshihet pas mediave për tërheqjen e nënshkrimit tim për hetimin e SHIK-ut. Unë edhe një herë po e them - unë e kam bërë tërheqjen e nënshkrimit tim për hetimin e SHIK-ut.

E kam tërhequr, sepse pa konsultimin tim është bërë formulimi, dhe pas marrëveshjes së dakorduar që kemi pasur për ndryshimin e formulimit, ajo nuk është përfillur. Unë nuk jam njeri i punëve copa-copa. Nëse i hyj një punë, ose dua ta kryej tamam, ose të mos i hyj hiç.

Deri sot s'kam rrëshqitur kurrë, as s'e kam ndërmend të rrëshqas në jetën politike dhe kombëtare. Edhe në këto lajthitje, të cilat dikush po përpiqet t'i bëj, as s'i kam bërë, a as nuk do t'i bëj kurrë.

Jam betuar para Zotit dhe para popullit që krejt jetën time do t'ia kushtoj këtij vendi dhe këtij populli dhe deri sot e kam bërë këtë dhe do ta bëj përsëri.

Nuk mund të punoj unë me njerëzit të cilët veprojnë sipas ndryshimeve klimatike dhe për interesa personale të dikujt, ose të personave të veçantë.

Unë nuk jam tërhequr, po e përsëris. Unë nuk jam tërhequr, janë tërhequr iniciuesit, pra jeni tërhequr ju iniciuesit dhe nëse keni bërë marrëveshje për këtë me dikën apo jo, këtë e dini ju. Pse jeni tërhequr nga formulimi, e dini ju. A keni bërë marrëveshje, apo jo. Prandaj, le të jetë e qartë pse e keni bërë. Unë nuk mund t'i bëj amnisti asnjë të keqeje dhe nuk do të bëjë amnisti asnjë të keqeje që i ndodh këtij vendi dhe këtij populli.

Nuk po i them sot të gjitha. Po jua tërheq vëmendjen, nuk po i them të gjitha arsyet pse e kam bërë tërheqjen, por nuk do të shkojë kohë e largët kur do ta kuptoni arsyen e vërtetë dhe të plotë, dhe jo vetëm që do të bindeni që kam të drejtë, por kam pasur shumë të drejtë, sepse jeta ime në politikë është jetë me një vizion, nuk është jetë euforike.

Është e vërtetë që AAK-ja nuk ka reaguar vetë publikisht, por i ka nxitur disa të tjerë të reagojnë. Kjo është shumë më keq. Unë kisha pasur qejf që drejtpërdrejt të jetë një reagim dhe të përballemi. Nëse ka dikush diçka me mua, ose me qëndrimin tim le të përballët, s'ka asnjë problem.

Është burrëri të dilet dhe të flitet përballë. Fatkeqësisht, ka mbetur pak burrëri në politikë, se janë do gra të forta që ende po e mbajnë politikën shqyr, e po e mbajnë këtë vend, se përndryshe ka pak problem.

Ju e dini që Ramush Haradinaj një kohë ka qenë kryeministër i Kosovës. Ka qenë një shans, të cilin ia ka dhanë presidenti Rugova, shans të cilin e ka kryer mirë, por sa ka mund të punojë më tutje nuk e di, por aq sa ka punuar, besoj ka punuar mirë.

Mirëpo, më habit fakti pse në atë kohë, kur ka qenë kryeministër, nuk e ka shtruar çështjen për hetimin e SHIK-ut, dhe pse këtë po e bën sot, kur është në opozitë. Unë nuk do të hyj në arsyet pse, sepse e dinë vetë pse e bëjnë një gjë të tillë. AAK-ja dhe askush mbi këtë tokë të mos mendojë se mund të më diktojë çka kam për të folur dhe si kam për të vepruar. S'më ka diktuar kurrë kush prej Milosheviqit e deri sot, dhe as s'do të më diktojë kurrë askush. Harrojeni këtë punë! Harrojeni se punoj me presione! Harrojeni se punoj me...

KRYETARI: Regjia, vazhdoja fjalën, të lutem!

MELIHATE TËRMKOLLI: Harrojeni se punoj punë të tjera të ndyra qysh i keni përfolur dhe qysh i përflitni. Melihate Tërmkolli nuk është në ato lista, nuk është në ato rende, nuk është në ata njerëz, nuk është në ato grupe të njerëzve.

Edhe një çështje shumë shkurtimisht: Para shumë kohe, një personi i është veshur puna e ashtuquajtur organizatë fantome SIA. Kjo vlen për Daut Haradinajn. Në pyetjen që ia kanë bërë gazetarët në një konferencë shtypi, nëse kanë burim tjetër, përveç gazetës "Svedok" të Serbisë, askush nuk është përgjigjur se ka ndonjë argument tjetër.

Sot, në Kosovën e pavarur, një deputet shqiptar, të flasë gjoja për SIA-n, unë e pyes: Zoti Daut Haradinaj, a ke ndonjë burim tjetër për organizatën fantome SIA, përveç të vetmit burim, që është gazeta serbe "Svedok". Shikojeni këtu mirë, gazeta serbe "Svedok". Edhe atëherë

kryeministër ka qenë Ramush Haradinaj dhe ka qenë njeriu më i informuar, bashkë me presidentin Rugova, se çfarë po ndodh dhe a ka pasur apo ka një organizatë të tillë.

Të gjitha institucionet thonë që nuk ka, as nuk ka pasur kurrfarë njoftimi se ka ekzistua kjo.

Dhe, në fund, po e përmend një fjalë të presidentit Rugova, për disa që janë ulur këtu e po merren me shumë me fyerje e me sharje: “Merruni sa të doni, por unë nuk do të merrem me ata që merren me mua”. Faleminderit!

KRYETARI: Xhevahire Izmaku e ka fjalën.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Kohëve të fundit, Republika e Kosovës, institucionet e saj, por edhe qytetarët e vendit janë provokuar me veprimet politike të ardhura kryesisht nga individë, apo grupacione politike që i kontrollojnë dhe i dirigjон komuniteti serb.

Kishim në fillim deklaratën skandaloze të ish-ministrit Jablanoviq, e më pastaj edhe të disa bashkëmendimtarëve të tij po në të njëjtën fushë, gjersa tani provokimi i radhës vjen nga një vendim i Kuvendit Komunal të Ranillugut, i nënshkruar nga Sasha Aleksiç, kryetar i këtij kuvendi lokal.

Në gjithë këtë mes, gjithsesi dikush qëllimisht ka dëshirë të luaj me ndjenjën, apo qëllimisht po bëhen veprime politike për të ngritur veprime motive, e që mund të çojnë deri te destabilizimi i vendit. Veprimet e tilla kanë qenë dhe e kanë arritur qëllimin që proceset në Kosovë të kthehen sikur në vitin 2000, apo 2004.

Institucionet e Kosovës, bashkë me partitë politike, nuk duhet të veprojnë me nguti ndaj këtyre veprimeve, për të mos nxitur kundërveprim emotiv.

Është forca e arsyes, procedura dhe respektimi i ligjit ajo që më së tepërmi i nevojitet vendit karshi provokimeve të tilla.

Qasja e një pjese të bartësve të politikës, e cila pretendon të jetë udhëheqëse e pakicës serbe dhe që nëpërmjet provokimeve të arrijë qëllimin politik nuk është së pari në interesin e vetë komunitetit serb, e madje konsiderohet që mos të jetë edhe vullnet i gjithë pjesëtarëve të këtij komunitetit, të cilët janë përcaktuar që si qytetarë të lirë të këtij vendi të jetojnë pra në shtetin e Kosovës.

Fillimi i procedurave në Kuvendin Komunal të Ranillugës me vendimin që rruga të mbajë emrin e shkaktarit të të gjitha luftërave në ish-Jugosllavi, kriminelit të gjykuar në Gjyqin e Hagës, apo njeriu që në Kosovë urdhëroi veprime për vrasjen e mbi 10 mijë qytetarëve, ndërsa dëboi edhe rreth një milion të tjerë, pra kasapit të Ballkanit, Milosheviq, pa dyshim që është provokim i

qëllimtë për të arritur te caku politik që është destabilizimi i vendit. Dhe, në një mjegull të tillë mos po arrijnë diçka për të përfituar politikisht padronët e tyre në Beograd.

Përball këtij provokimi, reagimi institucional ishte i duhur dhe ia vlen për ta përshëndetur. Qeveria e Kosovës, në fillim të javës, e ka paralajmëruar komunitetin serb, përkatësisht përfaqësuesit e tyre në Komunën e Ranigullut që të mos vazhdojnë me vendimin për ta emëruar një rrugë me emrin “Slobodan Milosheviq”.

Në këtë mes, punën e tyre, pra veprimin institucional, e kryen me sukses ministrinë përkatëse.

Duke pasur parasysh reagimin e institucioneve tona ndaj këtyre provokimeve, nuk ka pra arsye që subjektet tona politike, apo edhe opinionistë të ndryshëm të luajnë me ndjenjat e popullit për të ngjallur reagime emotive dhe joracionale.

Prandaj, rruget e vetme, e cila na çon në Evropë dhe përmirësimi i jetës së qytetarëve tanë është punë e përbashkët për forcimin e institucioneve, duke i respektuar ligjet, të cilat ne këtu vetë i kemi votuar, duke mos luajtur me ndjenjat e brishta të njerëzve të përvuajtur për të arritur qëllime politike gjithmonë në favor të atyre që nuk ia duan të mirën Kosovës.

Integrimi më i shpejtë i Kosovës në gjirin e shteteve të Evropës do të sjellë edhe stabilizimin e rajonit, njëherësh edhe zhvillimin e shpejtë socio-ekonomik që është qëllim i yni i përbashkët. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, i kemi edhe 20 diskutues të tjerë. Në fakt, edhe kështu nuk kemi në rend të ditës diçka të veçantë, i përfundojmë të gjithë ata të cilët janë, në qoftë se pajtohemi bashkërisht. I përfundojmë edhe pyetjet parlamentare, janë 42 sosh, pasi ashtu-kështu nuk kemi diçka të veçantë.

Albulena Haxhiu, nga Lëvizja “Vetëvendosje”, e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Të nderuar qytetarë të Republikës,
Të nderuar deputetë,

Gjatë javës që lamë pas, por jo vetëm, ishim dëshmitarë të shumë skandaleve të institucioneve të drejtësisë, gjithashtu edhe të organit më të lartë të Republikës, Gjykatën Kushtetuese, e cila drejtohet nga Enver Hasani.

Seria e shfaqjeve të fundit filloi me Këshillin Prokurorial, duke na shpërfaqur luftën e grupeve partiake dhe klaneve brenda këtij institucioni. Po t’i kishin denoncuar shkeljet e zvarritjet e çështjeve dhe të hetimeve, të ishin distancuar nga ata prokurorë që e shkelin ligjin hapur, do ta kishin edhe mbështetjen qytetare dhe sot s’do të kishin nevojë të kacafyteshin për funksionimin e këtij këshilli, duke na treguar për shantazhe.

Nga organi i Prokurorisë dhe këta këshilla gjithë çfarë mbajmë mend janë emra personazhesh, të cilët janë në fqinjësi me emra politikanësh e pushtetarësh. Ky është i Kadrisë, kjo është e Hajredinit, ky tjetri i Thaçit, ky është dost i Isës! Po si nuk folën një herë për gjendjen ku është katandisur sistemi i drejtësisë? Si nuk e thanë një herë të vërtetën për amnistinë e kriminelëve

serbë? Për ligj që gjoja sekuestron pasurinë e paligjshme? Për gjykatën e Prokurorinë e paligjshme në veri? Për Gjykatën Speciale? Për qindra dosje të krimit të organizuar e korrupsionit që nuk u hapën kurrë?

Shfaqja tjetër e radhës ishte ajo e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ku disa anëtarë të saj, tash, në fund të mandatit të tyre, po flasin për shantazhe. Tash, në këtë kohë, kur jashtëligjshëm po qëndrojnë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, kur po kontestohen mandatet e tyre. Pra, e kam fjalën për kryesuesin e KGJK-së, Enver Peci, dhe anëtares e KGJK-së, zonjën Valdete Daka.

Ishin po të njëjtët që dilnin në fotografi nëpër Bruksel me delegacionet e Thaçit dhe Edita Tahirit, e që u shkonin pas pushtetarëve të sotëm e të djeshëm në negociata e marrëveshje, ku i negocionin kompetencat dhe pavarësinë e institucioneve tona, ani pse me këtë bënin shkelje kushtetuese e ligjore. Tash u ra ndërmend që ranë pre e manovrave që vetë i kanë toleruar teksa përgjatë këtyre viteve ia dorëzuan pushtetit dhe para politikës çelësat e drejtësisë në vend, vetëm që t'i ruajnë favoret e tyre.

Në anën tjetër, Enver Hasani, ai që për kaq vjet, e drejtoi Gjykatën Kushtetuese të vendit tonë, institucioni që do të duhej të ishte lavdi i madh i secilit jurist në Kosovë, i secilit qytetar, i çdo intelektual e veprimtari që u përpoq për këtë Republikë, është sot personi që shënon nivelin më të ulët moral, profesional dhe njerëzor.

Nuk ka rast të rëndësishëm që është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese që nuk është shkruar zyrave të kabinetit të dikur kryeministrit Thaçi. Nuk ka rast me peshë për Kosovën që ky person, ky gjyqtar, Enver Hasani, nuk ka mbajtur anë kundër drejtësisë dhe kundër Kosovës. Po ta hulumtonte dikush nga jashtë këtë rast tonin me siguri do të konkludonte që kryetari i Gjykatës sonë është kundër Republikës, se s'ka si të shpjegohet ndryshe gjithë ky yrrysh destruktiv.

Çfarë mbeti nga Kushtetuta jonë pa u deformuar nga Gjykata Kushtetuese dhe Enver Hasani?

Të nderuar qytetare dhe qytetarë,

Të nderuar burra e gra,

Sot Republika mbahet peng nga ky institucion, i cili do duhej të ishte rojtar i saj. Falsifikimi i një vendimi të Gjykatës nga Enver Hasani është vetëm shkelja e fundit publike që e dimë, por është gati e sigurt se plot të tilla fshihen brenda zyrave të asaj gjykate. Ç'është ky njeri që të drejtat tona kushtetuese i përdor si plaçkë dhe trofe të tij?

Shtrohet pyetja se si ka mundësi që në këto institucione kaq të rëndësishme të vendit të na instalohen individë të tillë. Përgjigjja është e thjeshtë: një grup i korruptuar ende pa e marrë pushtetin, nga 2008 i instaloi mercenarët e tij deri në këtë institucion, i shfrytëzuan deri në fund garancitë kushtetuese që askush s'mund t'i kërkojë llogari tash Gjykatës Kushtetuese dhe po e mirëmbajnë njëri-tjetrin prej më së paku 7 vite, e lirisht mund të themi, të lehtësuar nga partnerët e tyre të mëhershëm e të tashëm prej 16 vjetësh.

Vetëm me një kërkim të thjeshtë nën emrin e kryetarit të Kushtetueses Enver Hasani të dalin para syve dhjetëra artikuj prej kur ishte rektor, e deri më tash, me raste nga më skandalozet. Prej aferave denigruese dhe korruptive me tenderë, gjatë kohës sa ishte rektor, te shkelja mbi

Kushtetutën dhe Republikën duke refuzuar të merret me shqyrtimin e marrëveshjes së dëmshme...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ia vazhdo të lutem fjalën, veçse mundësisht brenda kohës, ju lutem!

ALBULENA HAXHIU: ...legjitimimi i kapjes së Kuvendit dhe vendit nga PDK-ja, duke ia dhënë supremacinë Grupit Parlamentar të PDK-së, e në kundërshtim me rendin demokratik dhe kushtetues, për të përfunduar me skandalin e fundit, që është falsifikimi i kuorumit.

Pra, nëse ka një zyrtar shtetëror në Kosovë, i cili i ka shkatërruar edhe ato pak pjesë pozitive të Kushtetutës, ai kuptohet është Hashim Thaçi, mirëpo menjëherë pas tij është Enver Hasani. Tashmë e kemi të qartë se ecja jonë përpara si shoqëri kushtëzohet nga ndalja e tyre.

Tash është koha që t'u japim fund matrapazllëqeve, t'i heqim nga ato funksione në të cilat kanë ardhur, jo në emër të dijes, as në emër të konkurrencës e profesionalizimit, por në emër të pazareve, flirtimit me krimin dhe nënshtrimin ndaj tij dhe në emër të dëgjueshmërisë së pakufishme.

Këta na duan të heshtur, ndaj shpesh dhe na shtypin me mjetet e privilegjet që ne vetë ua kemi dhënë. Ne nuk i kemi asnjë borxh Enver Hasanit, këshillave prokurorialë e këshillave gjyqësorë. Ata na kanë borxh neve gjithçka. Gjykatat janë të popullit, burojnë prej tij, e janë për të. Çdo gjyqtar është aty përkohësisht. Nuk ekziston gjyqësia pa shtetin, drejtësia pa Republikën, e ligji pa shoqërinë.

Pra, koha e tyre po mbaron dhe sa më parë duhet të lëshojnë rrugë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! I kemi edhe 12 minuta për diskutime jashtë rendit të ditës, pasi shefi i madh i Grupit Parlamentar të PDK-së po reagon. Unë kisha kërkuar votim formal në qoftë se dëshironi të vazhdojmë. Janë të lajmëruar 20 diskutues për deklaramë jashtë rendit të ditës dhe 42 pyetje parlamentare. Në qoftë se e aprovon, vazhdojmë me të gjitha, në qoftë se jo atëherë shkojmë në bazë të kohës 30-minutëshi dhe 60-minutëshi. Urdhëroni me ngritje dore, a jeni për? Numëroi ju lutem! Mbajini duart vetëm, kush është për, ju lutem, deri të përfundojnë.

Jemi në votim: a të vazhdojmë me diskutimet e të gjitha 20 diskutimeve për deklaramë jashtë rendit të ditës edhe për 42 pyetje parlamentare, që t'i kryejmë sot.

(Reagime nga salla)

Po, për procedurë, kjo bëhet shmangie nga Rregullores. Urdhëro, zoti Grabovci! Vetëm me qetësi, ju lutem!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Jam ithtar i debatit dhe ngritjes së të gjitha çështjeve vërtet të preokupimit të qytetarëve të vendit pikërisht këtu në këtë foltore. Por, gjithsesi, jam edhe dëshmitar, sikur çdo qytetar i Kosovës, se

kjo foltore është shndërruar në një arenë të akuzave, të sharjeve, të fyerjeve e të shpifjeve të llojllojshme. Është shndërruar në një arenë ku asnjë institucion i këtij vendi nuk mbetet i ndershëm, asnjë përfaqësues i interesave të qytetarëve të Kosovës nuk mbetet i ndershëm, por është i korruptuar, është i sharë, është i fyer dhe ku do të shkojmë ne?

Ju lutem, ne kemi kërkuar këtu, jo rrallë, të hetohet SHIK-u dhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës i kam dhënë mbështetje të fuqishme. Jo vetëm SHIK-u, por kemi kërkuar decidivisht të hetohen dhe të gjykohen të gjitha dukuritë negative që kanë ndodhur në Kosovën e pasluftës dhe të gjithë kriminelët të dalin para gjykatës, e të mos shëtitin të lirë para hundëve tona. Të mos përdoret kjo foltore për të torturuar qytetarët e Kosovës për 15 vjet me radhë për të manipuluar me fatkeqësinë dhe tragjedinë e familjeve tona, të cilat i kanë humbur më të dashurit e tyre. Dhe, kjo për t'u keqpërdorur pikërisht në kohën e fushatave për të fituar poenë politike. Kjo është fatkeqësia më e madhe e atyre që pretendojnë të fitojnë në fatkeqësinë e popullit të vet.

Dhe, unë, kryetar, po kërkoj, mendoj arsyeshëm, të respektohet Rregullorja e Kuvendit. Janë 30 minuta të caktuar për deklarime jashtë rendit të ditës dhe kjo të shfrytëzohet dhe këta 30 minuta nuk janë të dedikuara për të sharë, për të fyer, por për të ngrehur vërtet shqetësimet e qytetarëve të vendit, preokupimet që i kanë qytetarët e vendit dhe ato nuk janë të pakta.

Edhe një herë po them - jo për të sharë dhe për të fyer. Prandaj, unë kërkoj që të respektohet Rregullorja e Kuvendit.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë Adem Salihaj e ka fjalën.

(Reagime nga salla)

ADEM SALIHAI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Unë sot për ne dhe për qytetarët e Kosovës dua ta hap një çështje, çështjen e kazinove në Kosovë.

Jemi një vend i pazhvilluar, jemi një vend me papunësi të madhe, jemi një vend ku migrimi është bërë masiv, jemi një vend ku varfëria është e skajshme. Nuk jemi një Monaco apo Las Vegas dhe unë çuditërisht shumë se si na ka ndodhur kjo dukuri kaq e përhapur, kur në një qytet ku unë jetoj kanë qenë së paku 54 kazino.

Nuk e di në këto vende ku janë të përhapura nëse është në masë të madhe. Nuk e di si e kanë këtë vendet në rajon, por për situatën tonë ekonomike dhe sociale mendoj që janë plotësisht të paarsyeshme.

Unë dëshiroj të theksoj se te unë personalisht kanë ardhur gra të martuara me shumë fëmijë në familje me lot në sy, më kanë lutur që unë ta hap këtë çështje dhe ne si Parlament, bashkë me Qeverinë, ta marrim një hap që t'i ndalojmë kazinotë në Kosovë.

Pse është kjo arsye? Ato gra më kanë pohuar se gurrat e tyre atë pagë të vogël që e kanë shkojnë e humbin në kazino dhe ato gra të ndershme familjare janë detyruar të ushtrojnë prostitucion për t'i mbajtur fëmijët e tyre, sepse s'kanë pasur asnjë zgjidhje tjetër.

Mendoj se një situatë kaq johumane me një prapambetje kaq të madhe ekonomike, me varfëri të skajshme, me migrim masiv, me të gjitha këto dukuri që na përcjellin nuk do të na lejonte që ta kemi një numër kaq të madh të kazinove në Kosovë dhe kërkesa ime është në emër të atyre grave, të atyre familjeve, në emër të të gjithëve që ne ta ndërmarrim një hap dhe ta ndryshojmë ligjin t'i ndalojmë kazinotë në Kosovë, sepse nuk është mirë që ne si Parlament të veprojmë kësioj dhe ta lejojmë këtë situatë të rëndë dhe një zhvatje prej këtyre kazinove.

Unë kërkoj nga kryeministri që të ndërmarrë hapa për ndryshimin e ligjit përkatës, që bashkërisht me ne t'i ndalojmë kazinotë në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Rrustem Berisha nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Enver Hoti të bëhet gati nga "Nisma", Duda Balje të bëhet gati nga "6+", Nait Hasani nga PDK-ja, Besa Gaxherri nga LDK-ja.

(Ndërprerje nga regjia)

RRUSTEM BERISHA: Faleminderit, kryetar!

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Tema që do ta trajtoj sot ka të bëjë me verifikimin e veteranëve dhe njohjen e statusit të tyre dhe të gjithë atyre që në çfarëdo forme kontribuan për lirinë e Kosovës.

Unë sot flas në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe mendoj që kjo temë është në interes për të gjithë ne deputetët, qytetarët e Kosovës, por në veçanti për veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Unë besoj dhe jam i bindur se të gjithë ne pajtohemi që të gjithë ata që sakrifikuan dhe kontribuan në luftën për çlirimin e Kosovës e meritojnë një respekt dhe trajtim dinjitoz nga populli dhe shteti i Kosovës, sepse këta janë njëri ndër faktorët kryesorë që sollën lirinë dhe pavarësinë e vendit tonë.

Prandaj, duhet t'i kuptojmë edhe shqetësimet e veteranëve dhe të gjithë atyre që po i shfaqin në kohën e fundit në forma të ndryshme rreth pakënaqësive dhe rreth verifikimit që po u bëhet atyre.

Arsyet e pakënaqësive, në radhë të parë, unë mendoj se është ligji, i cili nuk i trajton këto kategori në mënyrë meritore. Pse them se është Ligji i veteranëve i miratuar në vitin 2014 që nuk i trajton mirë këto kategori?

E para, ky ligj nuk është gjithëpërfshirës dhe është përjashtues për një kategori të luftës.

E dyta, nuk i trajton mirë luftëtarët, të cilët kanë luftuar në vitet '97-'98 dhe e detyron zinxhirin komandues dhe komandantët që të bëjnë shkelje të vazhdueshme të këtij ligji për të mos u konfrontuar me luftëtarët, të cilët e meritojnë ta gëzojnë statusin e veteranëve, sepse në këtë ligj është e paraparë të ketë përfundim të luftës. Pra, luftëtar veteran është ai e cili e ka përjetuar përfundimin e luftës.

E dimë se secila luftë i ka specifikat e veta, por ne duhet të bazohemi edhe në praktikën e shteteve të rajonit se në çfarë forme i kanë zgjidhur ata këto probleme. Për shembull, e kemi në Kroaci...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdoja fjalën, të lutem, regjia!

RRUSTEM BERISHA: ... Në Kroaci kanë marrë pjesë fillimisht "Zengi", pastaj Ushtria kroate, policia, kanë qenë njësitë e Paragës, por në fund të luftës të gjithë këta janë trajtuar në mënyrë dinjitoze dhe nuk i është mohuar askujt e drejta që t'i gëzojë beneficionet e këtij shteti.

Prandaj, unë propozoj që edhe në Kosovë të bëhet një gjë e tillë dhe të merret për bazë forma se si është trajtuar dhe si trajtohen kategoritë e dala nga lufta, duke iu përshtatur kategorive tona. Ne e dimë se edhe ne në Kosovë i kemi pasur specifikat tona, i kemi pasur organizimet dhe formacionet tona dhe duhet trajtohen të gjithë ata, të cilët me çfarëdo forme kanë kontribuar për lirinë e Kosovës.

Dua të jemi të sigurtë se Komisioni për Verifikim dhe të gjithë ata deri më tani nuk kanë bërë ndasi, por kjo duhet të rregullohet me ligj. E kanë pasur të drejtë të aplikojnë të gjithë ata që kanë pretenduar që u takon njëri prej statusit të këtyre kategorive, por kjo duhet të definohet me ligj. Dhe, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka nisur iniciativën e nënshkrimeve për ndryshimin e ligjit.

Prandaj, i ftoj të gjithë deputetët që ta nënshkruajnë këtë iniciativë, sepse kjo është në të mirën e të gjithëve. Pra, nuk është në të mirën e individit, sepse vetë verifikimi i veteranëve bëhet në nivel shtetëror dhe duhet t'u njihet të gjithë atyre që në çfarëdo forme kanë kontribuar për lirinë e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Besa Gaxherri, pastaj Enver Hoti me marrëveshje ka kaluar në fund. Komisionet parlamentare nuk janë arsyetim për arsye se në kohën e seancave nuk ka mbledhje të komisioneve parlamentare. Të jemi korrekt ndërmjet vete.

BESA GAXHERRI: Kolegë deputetë,
Zoti Veseli,

Ju kisha lutur kësaj here, s'po them më shumë, veç ju lus të jeni ë më korrekt kur unë e kërkoj fjalën. Nuk është hera e parë dhe të kisha lutur, publikisht po të lus!

Kolegë të nderuar dhe Kabinet qeveritar,
Zoti kryeministër,

Sot do ta ngre çështjen në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës në lidhje me shkatërrimin e lumenjve dhe ndotjen e tyre.

Duke marrë shkas nga ankesa e fshatit Gllaviçicë në Komunën e Pejës, pra LDK-ja ngre çështjen e eksploatimit dhe ndotjes së paligjshme të lumenjve në Kosovë.

Siç e dimë të gjithë, gjendja e lumenjve në Kosovë është alarmante. Ministritë e linjës nuk i kanë kryer obligimet ligjore vite me radhë për ta ndaluar degradimin e lumenjve. Si shembull, po ju marr ankesën konkrete, e cila e pasqyron gjendjen e njëjtë në tërë Kosovën.

Ankesa është kjo dhe po jua lexoj: “Që nga viti 2001 operojnë disa gurthyes në fshatin tonë, aktualisht janë tetë operatorë në një fshat, shkalla e dëmtimit të të cilëve është katastrofale dhe e papërmirësueshme. Operatorët funksionojnë pa ndërprerë dhe nuk pengohen fare.

Të njëjtit veprojnë jashtë çdo rregulle të mundshme dhe pa asnjë licencë në lidhje me marrjen e zhavorrit në shtratin e lumit.

Dëmet e këtyre keqpërdoruesve janë me fatalitet për aktualitetin dhe të ardhmen e fshatit tonë, ngase marrja e zhavorrit pandërprerë plot 14 vjet ka bërë që niveli i Bistricës të bije për pesë metra në nivelin ekzistues.

Me rënien e nivelit është bërë i pamundshëm kthimi i ujit për ujitjen e tokave tona. Sipërfaqja e tokave që ujiten është më se 300 hektarë, sipërfaqe kjo e cila po pamundësohet të ujitet nga e vetnja arsyë - nga gurthyesit dhe eksploatuesit ilegalë.

Dëme të konsiderueshme kemi në florën dhe faunë të fshatit, bimësia rreth lumit totalisht është e dëmtuar, pemët, drunjtë shumëvjeçarë, drunjtë dekorativë e të tjerë. Lumi ka qenë jashtëzakonisht i pasur me peshq, mirëpo kjo faunë është shkatërruar totalisht. Fshati e ka burim të vetëm jetese bujqësinë, bujqësi kjo e pamundshme aktualisht për shkak të mungesës së ujitjes së tokave.

Fakti që neve po na pamundësohet të ujitim, pastaj dëmet në florën dhe faunën në fshatin tonë është baza e vetme që apelojmë dhe kërkojmë reagim të menjëhershëm nga institucioni juaj - Kuvendi i Republikës së Kosovës”.

Kolegë deputetë,

Kjo është një ankesë, e unë e kam materialin tërësisht të protokolluar, me të cilin ata i janë drejtua Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, Ministrisë së Mjedisit të Planifikimit Hapësinor, Drejtorisë për Punë Inspektuese në Kuvendin Komunal në Pejë, si dhe kryetarit të Komunës. Domethënë, të gjitha këto shkallë ata i kanë kaluar dhe kanë mbërri deri te deputetët në Kuvendit e Kosovës. Me këtë unë jua lexova konkretisht ankesën të cilën e kanë bërë ata dhe në emër të kësaj disa foto se si duken arat dhe puna që e bëjnë fshatarët në këtë fshat të betonizuar. Është i betonizuar. Ministri i Mjedisit nuk qenka këtu. Dhe, foto të tjera të cilat tregojnë se tokat pjellore janë shkatërruar, e kështu me radhë.

Andaj, në bazë të kësaj gjendjeje, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: I ka pasur pesë minuta, ende s'i ka mbaruar, nuk e di pse u ndal. Ju lutem, regjia, vazhdoja!

BESA GAXHERRI: Andaj, bazuar në këtë që kjo gjendje është në nivel të Kosovës, nuk është vetëm në nivelin komunal, apo të një fshati, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ministrit të Ambientit, zotit Agani, dhe ministrive të linjës u jap afat deri në muajin qershor që ta futin nën kontroll gjendjen alarmante të shkatërrimit dhe të ndotjes së lumenjve në nivel vendi.

Njëkohësisht, e ftojme Komisionin për Bujqësi dhe për Mbrojtje të Ambientit që menjëherë t'i formojë grupet monitoruese për ta monitoruar gjendjen faktike në terren, t'i evidentojë shkeljet ligjore dhe t'i sjellë Kuvendit raport me rekomandime konkrete.

Pas qershorit, Kuvendi do ta analizojë gjendjen dhe në qoftë se nuk do të ketë ndryshime rrënjësore do të kërkojmë përgjegjësi drejtpërdrejt në ministritë e linjës.

Faleminderit për vëmendje dhe besoj që ne të gjithë, edhe komisionet punuese në Kuvendin e Kosovë, por edhe Qeveria jonë, do të punojmë dhe këtë gjendje alarmante do ta futim nën kontroll.

Po e përmendi edhe një gjë: unë udhëtoj nga Peja për Prishtinë gati çdo ditë. Këtyre ditë kisha kërkuar nga ministri, por nuk qenka as ministri i Telekomunikacionit, të shihet rruga magjistrale, në të cilën janë investuar miliarda ashtu me nivel evropian dhe në atë magjistrale nuk mund të kalosh. Ka aq shumë baltë dhe aq shumë papastërti, e këto tash nuk dua t'i shqyrtoj ose diskutoj pse janë, por i kisha lutur ministritë e linjës të merren me ato rrugë, të cilat ne së paku i kemi ndërtuar, që t'i mirëmbajmë dhe të mos krijojmë fatkeqësi gjatë udhëtimit, sepse rruga vërtet është e pakalueshme. Faleminderit!

KRYETARI: Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJA: Zahvaljujem!

Faleminderit, kryetar!

Poštovani premijeru, baš mi je drago da vas vidim danas ovde. Mi smo na ime zajednice puno puta tražili sastanak da se vidimo sa vama da pričamo o položaju drugih manjinskim zajednica osim srpske ovde na Kosovu. Danas imam priliku da vas gledam i da kažem neke naše krucijalne probleme sad u ovom momentu.

Potpisali ste sporazum u Briselu za imenovanje sudija na severu Kosova, i u svi 15. tačaka niste našli za shodno da ubacite niko kod ostalih zajednica, bar da spomenete u jednoj rečenici.

Ja sam vam dostavila jedno pismo u ime svih šest zajednica ovde na Kosovu koje nisu srpske, dostavljala sam i predsednici države i gospodje Edita Tahiri sa jednom molbom da se dopuni taj sporazum ukoliko je moguće. Bojim se da je takvi sporazum bio i pre ovog, a da će takvi sporazumi možda biti i posle ovog, ali mislim da je vaša obligacija bila, naravno da nisam to

očekivala od gospodina Vučića, ali od vas sam očekivala da spomenite bar da ovde na Kosovu, pored Srba, postoje i druge zajednice.

Vi gospodine Premijeru znate da u ovom momentu zbog bojkotovanja centralnih organa od strane Srpske liste mi nemamo kao ostale zajednice niti Ministarstvo za Zajednice u kojima možemo da odemo. To ministarstvo, koliko znam, nije samo srpsko, nego je pripadalo svim zajednicama. Mi momentalno tu nemamo ministra, i apsolutno smo hendikepirani u smislu da možemo da pomognemo našim ljudima svako u svojoj zajednici.

Kancelarija pri uredu Premijera za pitanje manjina nema svoga direktora. Mi Bošnjaci stalno tražimo formiranje opština. Ministar za lokalnu samoupravu ni on ne dolazi na posao, znači tako da smo sve ostale zajednice u ovom momentu, znači bojkotovanje Srpske liste sve nas povuklo mnogo, mnogo duboko, tako da se u ovom momentu ne postoji institucija u kojima možemo da se obratimo i da dobro i kvalitetno radimo svoj posao.

Zato Vas sada molim, u ime svih 6 zajednica koji nisu srpske na Kosovu, da malo više obratite pažnju na nas, jer 10 je poslanika iz Srpske liste ovde u parlamentu, ali i 10 je poslanika iz ostalih zajednica. Danas sam čula na medijima da oni neće da se vrate u Skupštinu Kosova dok se ne ispune svi njihovi uslovi. Mi do sada nismo radili pod takvom sistemom, ali 10 je nas, 10 je njih, pa ja vas molim znači sad, u ime svih šest, svih drugih zajednica, znači svih zajednica na Kosovu da malo obratite pažnju na nas, jer mi smo ovde i bili smo uvek ovde.

KRYETARI: Nait Hasani e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Komisioni për Arsim, Teknologji, Kulturë, Sport dhe Diasporë e ka bërë një vizitë në Luginën e Preshevës në mënyrë zyrtare dhe atje e ka gjetur një gjendje mjaft të rëndë të qytetarëve shqiptarë në komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Atje kemi hasur në shumë probleme ose çështje për të cilët ata kanë nevojë për ne. Ata kanë nevojë për një mbështetje dhe ata kanë nevojë për shtetin e Kosovës.

Në shkollat e tyre dhe në takimet me kryetarët e komunave të Preshevës, Bujanocit dhe zëvendëskryetarin e Komunës së Medvegjës ne kemi hasur në ato probleme, të cilat ata i kanë shtruar para nesh si Komisioni i Arsimit, që kemi shkuar zyrtarisht si shtet i Kosovës në Serbi.

Ne kemi hasur dhe kemi parë që atje tekstet shkollore janë konfiskuar dhe ata nxënës nuk mund të mësojnë me abetaren në gjuhën shqipe.

Serbia edhe pas kaq kohësh nuk i ka njohur edhe nuk i njeh tekstet shkollore në gjuhën shqipe që botohen në Kosovë. Dhe, diku 5 000 libra janë konfiskuar në shkollën e Rincës dhe janë pjesë e policisë në Preshevë. Është burgosja e librit dhe Serbia ende mendon me mentalitetin e shekullit XVIII, kur në kohën e Turqisë na konfiskoheshin abetaret dhe e merrnim rrugën e shkronjave.

Atje duhet të dilet në ndihmë dhe këtë ndihmë mund ta japë shteti i Kosovës, mund ta japë kryeministri, mund ta japin ministrat, mund ta japin të gjithë.

Ata kanë nevojë për tekste dhe ato tekste duhet t'ia çojmë, sikur që ua japim nxënësve tanë falas në shkollën fillore, prej klasës së parë deri në klasën e tetë.

Ata e kanë çështje edhe nostrifikimin e diplomave, të cilët e kanë kryer fakultetin në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, në fakultetet apo universitetet tjera.

Për këto nostrifikime kanë qenë një agjenci në Ministrinë e Arsimit - SPARK, e cila dikur u ka lëshuar nostrifikime, e tash nuk funksionon, dhe ata në konkursat e tyre nuk kanë mundësi të marrin pjesë për shkak se eliminohen, ngase nuk u njihet diploma.

Kërkohet që studentët, të cilët dëshirojnë të studiojnë në universitetet e Kosovës, të mos kenë kuota, sepse ata po diskriminohen në këtë drejtim.

Diskriminim do të thotë t'i eliminosh ata...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Nait, mirë se ke ardhur shëndosh! Kam marrë sot mjaft kritika. Kam marrë kritika reale për arsye se nga pak dikujt ia kam bërë të drejtë, e dikujt të padrejtë. Nait, kërkoj falje pasi të kam bashkëpartiak mund të ta ndal. Enver Hoti e ka fjalën.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Më 5 mars 2015, gazeta “Koha Ditore” e botoi një shkrim, i cili solli fakte të rëndësishme të cilat implikojnë institucionet vendore e ndërkombëtare në ndërhyrjen e Gjykatës së Apelit në shtator të vitit 2014, e që kishte për qëllim që zoti Fatmir Limaj dhe tetë të akuzuar të tjerë të rastit “Kleqka” të dënoheshin për krime lufte.

Duke u thirrur gjithnjë në fakte të cilat i ka sjellë kjo gazetë, dënimin e kishte garantuar gjyqtari portugez i EULEX-it, zoti Manuel Suarez, i cili ishte kryetar i trupit gjykues.

Po ashtu, zoti Suarez u kishte thënë kolegëve të tij të EULEX-it se do ta dënonte zotin Limaj ende pa e marrë lëndën në gjykim.

Të gjitha këto dëshmi i sjell gazeta “Koha Ditore” në shkrimin e saj, të botuar më 5 mars 2015. Të gjithë këtë burim të informacionit e ka sjellë një këshilltar ligjor i Gjykatës së EULEX-it, i cili ka kërkuar nga organet kompetente mbrojtje, të cilat nuk i kanë ofruar.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot me të drejtë dhe me shqetësim të madh nga të gjithë qytetarët po shtrohet pyetja: çfarë është duke ndodhur në institucionin më të rëndësishëm të vendit tonë, atë të drejtësisë, i cili institucion në vend që t'i mbrojë dhe të garantojë qytetarët në çfarëdo procesi gjyqësor qoftë ai për një gjykim fer, të paanshëm dhe të pandikuar politikisht, gjë të cilin e garanton Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.

Por, fatkeqësisht, këtë të drejtë as nuk e garanton, e as nuk është i interesuar institucioni i drejtësisë ta sigurojë, sepse ky institucion është shndërruar në instrument të politikave dhe të grupeve të caktuara.

Me keqardhje dua të theksoj se aq sa është shqetësuese tentativa e instruktuar e zotit Suarez për ta marrë një vendim gjyqësor, i cili do ta cenonte rëndë të drejtën e individit të njohur edhe të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës për zotin Limaj dhe të tjerët, po ashtu hiç më pakë nuk është shqetësuese as heshtja e institucioneve ndërkombëtare, të cilat erdhën këtu për ta vendosur rendin dhe ligjin...

Akoma më shqetësues dhe rrëqethës është fakti i mosreagimit të Qeverisë dhe i aktorëve të mundshëm si pjesëmarrës në këtë tentativë për t'i eliminuar kundërshtarët politikë, me të vetmin qëllim për t'i shtyrë përpara agjendat e tyre politike.

Të nderuar deputetë,

Mosreagimi për zbardhjen e këtij rasti shumë të rëndë e jonjerëzor për sistemin e drejtësisë në vendin tonë me pasoja shumë të rënda për familjen edhe për zotin Limaj dhe bashkëluftëtarët e tij. Secili nga ne do të duhej ta shqyrtojë pyetjen: ku jam unë, ku është familja ime nesër, ku është sot dhe nesër shoqëria kosovare në një drejtësi të tillë?

Deputetë, jo minutat m'i jep kryetari, sepse ma ka marrë pak kohën më herët, besoj se ma zgjat...

Nga kush po frikohemi sot? Prandaj, ekziston një frikë e madhe për të reaguar dhe shtrohet pyetja: Nga kush po frikohemi të reagojmë për një të drejtë shumë elementare, siç është e drejta për mundësitë e barabarta para ligjit. Deputetët, Qeveria, intelektualët, shoqëria civile, në përgjithësi e gjithë shoqëria kosovare, e veçmas Ministria e Drejtësisë, do të duhej të reagoonte për këtë skandal, i cili e ka goditur në themel funksionimin dhe besimin në institucionin e shenjtë të Republikës së Kosovës, siç është Gjyqësori.

Prandaj, ne si qytetarë, nëse te ky institucion nuk e gjejmë barazinë, ku do ta kërkojmë atë? Kush e garanton sigurinë tonë për të vepruar lirshëm në aktivitete politike, ekonomike e zyrtare? Secili nga ne në këtë sallë, sot, nesër, apo kurdo qoftë, nëse mendojmë dhe punojmë ndryshe nga pushtetarët dhe biem ndesh me agjendat e tyre dhe të klaneve të tyre, mund të bëhemi 'mish për top', siç thotë populli, prandaj të reagojmë sot, për të mos qenë vonë nesër.

Asgjë nuk është më njerëzore sesa të reagosh ndaj së keqes kurdo...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdojani fjalën, ju lutem!

ENVER HOTI: ...andaj ne, i nderuar ministër i Drejtësisë, edhe pse nuk është këtu, kërkojmë nga ju që ta shfrytëzoni pozitën tuaj funksionale që ta zbuloni dhe ndriçoni deri në fund të vërtetën lidhur me skandalin e faktuar në "Koha Ditore" për rastin Limaj dhe 8 pjesëtarët e tjerë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të njohur si rasti "Kleçka", ose në të kundërtën tregojini

opinionit të gjerë publik pse është kjo heshtje nga ju. Nga çka keni pengesa, apo, edhe për me keq, nga kush mund të frikoheni?

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër dhe qeveritarë,

Gjithë spektrit politik dhe shoqërisë kosovare i bëjmë thirrje që të punojmë me të gjitha kapacitetet tona njerëzore e intelektuale për ta ndërtuar një shtet të së drejtës ku askush, në asnjë rrethanë dhe për asnjë pikëpamje të tij politike nuk do të linçohet në të ardhmen. Faleminderit për vëmendjen tuaj dhe ju kërkoj falje nëse fjalimi ishte i zgjatur. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Danush, më vjen keq se po marr kritikë. Janë edhe 15 diskutues, i lëmë për radhën e ardhshme. E përfunduar për sot, kërkoj falje, pasi nuk po mund, edhe pse dëshira ime personale ka qenë t'i kryejmë sot. Ecim në pikën e dytë të rendit ditës.... Dëgjo, marr kritika shumë po ta thyej edhe një herë...

(Reagime nga salla)

I pari ka qenë Bekim Haxhiu prej fillimit. Thjesht, ju kisha lutur për mirëkuptim! Me qejfin më të madh do të kishim vazhduar.

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1, të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta dhe do të jetë vetëm kaq. Ky është vendimi juaj. Për këtë seancë janë parashtruar 42 pyetje parlamentare.

E ftoj deputetin Palë Lekaj, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Kryeministër,

Ministra,

Deputetë,

Sa i përket pyetjes sime, kanë qenë dy pyetje atëherë kur janë bërë vërshimet dhe pyetja e parë është se sa ka Qeveria informacione për dëmet e shkaktuara nga vërshimet e mëparshme dhe sa është në gjendje Qeveria të bëjë subvencionimin e këtyre dëmeve?

Pyetja tjetër ka të bëjë me shlyerjen e borxheve të fabrikës, se me të vërtetë është bërë dasmë, e deri më sot askush nuk është marrë me atë për t'i shlyer borxhet e tyre. Prandaj, edhe pse në këtë Kuvend është marrë vendimi që të bëhet shlyerja e borxheve të këtyre punëtorëve, deri sot askush nuk është marrë me ta. Po ashtu, është edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese, e deri më sot askush nuk e ka implementuar këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni, i nderuar kryeministër!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti Lekaj!

Tash sa u përket dëmeve të vërshimeve, ne kemi pasur vetëm intervenimet e FSK-së në regjionin e Lipjanit, ku është kërkuar që të intervenojë, mirëpo nuk kemi pasur asnjë kërkesë të komunave tjera për intervenime, qoftë të Qeverisë, qoftë të ministrive përkatëse. Nuk kemi edhe asnjë kërkesë nga komunat në Qeveri lidhur me kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet, ndërkaq ne do ta kemi parasysh kërkesën tuaj që gjatë ndarjes të subvencioneve për bujqësi ta kemi si prioritet edhe ndarjen në regjionet ku ka pasur dëme nga vërshimet.

Sa i përket pyetjes së dytë që ndërlidhet me kompensimin, përkatësisht me pagesat që duhet të bëhen për punëtorët e Fabrikës së Gypave në Ferizaj, ne me Buxhetin e Republikës së Kosovës nuk kemi mjete të ndara për këtë kompensim. Buxhetin e kemi aprovuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe jashtë pozicioneve buxhetore nuk kemi mundësi të intervenojmë, ndërkaq në AKP është vlera e shitur e fabrikës, por ajo vlerë nuk e mbulon vendimin e Gjykatës për kompensimin e punëtorëve dhe unë mendoj se edhe vendimi duhet të ishte në suazat e vlerës, sepse nuk mund të merren paratë nga shitja e fabrikave të tjera, përkatësisht pronave tjera, për kompensimin e një prone të caktuar sepse është e rregulluar me Ligjin për AKP-në. Unë nuk shohë mundësi që këtë ta bëjmë me Buxhetin e Republikës së Kosovës, por Gjykata e cila e ka sjellë vendimin duhet ta adresojë se nga cilat mjete mund të bëhen dhe në çfarë shume mund të bëhet ky kompensim. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Pal Lekaj, përsëri. Ministri nuk është, do ta bëni pyetjen?

PAL LEKAJ: Meqë nuk është ministri, atëherë nuk do ta bëj pyetjen.

KRYETARI: Po ashtu, deputetja Time Kadrijaj, do ta bëni pyetjen, pasi nuk është ministri? Vetëm urdhëroni!

TIME KADRIJAJ: Meqenëse është radha e dytë që ministri nuk është këtu dhe pyetja më nuk ka të drejtë të parashtrohet, unë sot do ta parashtroj, edhe pse ministri nuk është i pranishëm.

Shumë nga vendet e BE-së nuk e lejojnë dyshtetësinë, prandaj kjo ka bërë që shumë qytetarë kosovarë ta fshijnë dyshtetësinë. Pyetja ka qenë: Pse qytetarët të heqin dorë nga shtetësia dhe cili është numri i tyre? Mirëpo, sipas disa statistikave, deri në vitin 2013, numri i qytetarëve që kanë hequr dorë nga nënshtetësia ka qenë 14 032 persona, ndërsa në tre vjetët e fundit rreth 4 000 persona kanë hequr dorë nga dyshtetësia. Çfarë ka bërë Qeveria paraprake dhe çfarë do të bëjë kjo Qeveri që të bisedojë me këto shtete anëtare të BE-së që qytetarëve shqiptarë kosovarë t'u lejohet njohja e dyshtetësisë? Apo qëllim i kësaj Qeverie është, sepse me rrjedhën e migrimit ilegal shumë qytetarë i kemi lejuar që të shkojnë në vendet e BE-së, por duke e përfshirë edhe numrin e qytetarëve që po e humbin dyshtetësinë, Kosova do të mbetet edhe pak vite me 1 milion banorë.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Pyetja për kryeministrin Mustafa është: Gati çdo ditë nëpër media dëgjojmë që zbulohen varreza masive në Serbi, e temë e diskutimit ndërmjet delegacionit serb dhe shqiptar në Bruksel nuk ishte çështja e të pagjeturve. Unë e pyes kryeministrin se kur do të jetë në tavolinë çështja të

pagjeturve, në mënyrë që kjo temë sado pak të zbutet nga familjarët, që ata të ndihen se dikush po përkujdeset të paktën sadopak minimalisht nga Qeveria. Kur do të jetë temë e diskutimit në bisedimet Kosovë-Serbi çështja e të pagjeturve?

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit deputete Haxhiu!

Në takimin e fundit në Bruksel ne i kemi hapur disa tema, jo me delegacionin e Serbisë, por me përfaqësuesin e lartë Mogerini, për të cilat ne e kemi interesimin tonë që të jenë çështje të diskutimit në Bruksel. E kemi hapur çështjen e implementimit të marrëveshjeve të deritanishme; çështjen e lëvizjes së lirë të qytetarëve në veri; çështjen e zhbërjes së strukturave të mbrojtjes civile në veri të vendit, sepse ato akoma funksionojnë; çështjen e eliminimit të organeve paralele, të cilat po i vendos Serbia, edhe përkundër marrëveshjeve të nënshkruara në Bruksel; problemin e energjetikës; problemin e sigurimit të automjeteve; problemin e kodit telefonik; demarkacionin e kufirit, i cili po ashtu duhet të jetë një çështje që duhet të përfundohet dhe të përmbyllet, dhe po ashtu e kemi hapur çështjen e të pagjeturve, të cilën duhet ta diskutojmë në Bruksel.

Nuk e kemi përcaktuar kohën se kur duhet ta diskutojmë këtë, por kemi thënë se është një çështje e cila domosdoshmërisht duhet të diskutohet, jo vetëm që t'u japim përgjigje familjeve të cilat i presin ata, por është një çështje e cila domosdoshmërisht do të japë përgjigje dhe do të vazhdojmë edhe më tutje në të gjitha takimet që i kemi me përfaqësuesin e lartë. Edhe në takimin që do ta kemi mendoj në këtë muaj, sepse ai do të vijë në Kosovë që ta shtrojmë këtë çështje dhe të kërkojmë që të jepet përgjigje për të.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, deputete?

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit! Nuk kam pyetje shtesë, por uroj që kjo çështje të kryhet njëherë e përgjithmonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ibishi, pyetje për ministrin Imet Rrahmani. Zoti Ibishi, e keni fjalën!

NUREDIN IBISHI: I nderuar kryesues,

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar dhe të nderuar të pranishëm,

Edhe pse këtë pyetje e kam lexuar, por për mungesë të pranisë së ministrit, edhe se kjo çështje edhe pse është dashur t'i drejtohet ministrit në mandatin e kaluar, ka të bëjë me 11 specialistët e stomatologjisë si kuadër deficitar tash të papunë, dhe i janë drejtuar disa herë ministrit të mandatit të kaluar për të protestuar dhe kanë protestuar para Ministrisë me qëllim kthimin në vendet e tyre të punës si specialistë të stomatologjisë në bazë të automatizmit dhe praktikës të përhershme dhe sipas a vendimit, u është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Kjo krejt bie ndesh me kontratën e punës të secilit nga këta 11 specialistë, ku në pikën 10, a dhe b) ceket domosdoshmëria e kthimit në shërbim shëndetësor publik të Kosovës, pas

përfundimit të specializimit. Pra, ish-ministri i ka pranuar, por është ankuar se për shkak të mungesës të mjeteve buxhetore nuk ka mundur t'i realizojë.

Në shumë komuna, ku është bërë kontrolli shëndetësor, sidomos për fëmijët parashkollorë dhe shkollorë janë gjetur shumë të meta te fëmijët ku mungojnë masat e parandalimit me gjetje të deformiteteve dhe anomali të trashëguara nga sëmundjet dentale, kardiake, të pamurit e të tjerë.

Pyetja ime për ministrin Rrahmani është e drejtpërdrejtë nëse keni planifikuar ndërmarrjen e masave dhe veprimeve në ngritjen e vetëdijesimit të qytetarëve për masat primare mjekësore, me zgjerimin e kapaciteteve të punësimit, personelit mjekësor dhe kujdesit primar shëndetësor të fëmijëve parashkollorë dhe shkollorë, duke iu referuar parandalimit, zbulimit dhe mjekimit të anomalive dhe sëmundjeve të ndryshme dhe çka do të ndërmerrni në vitet pasueses buxhetore për këta 11 specializantë të stomatologjisë, shumica e të cilëve janë specialistë ..., që padrejtësisht kanë mbetur pa punë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rrahmani, e keni fjalën!

MINISTRI IMET RRAHMANI: I nderuari kryesues!

I nderuari kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

I nderuari zoti Ibishi,

Çështja që ngrehni është shumëdimensionale dhe shumë herë edhe multisektoriale, por mbi të gjitha njëra nga çështjet që duhej të ishte trajtuar në vazhdimësi dhe me seriozitetin më të madh.

Promovimi i shëndetit, edukimi i popullatës dhe parandalimi i sëmundjeve janë obligime ligjore edhe për Ministrinë e Shëndetësisë. Programet e tilla promovuese dhe parandaluese në të shumtën, janë pjesë e aktiviteteve në kujdesin parësor shëndetësor, por pa e harruar edhe kupolën e këtyre aktiviteteve - Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik në baza ditore. Sigurisht se shënimi i ditëve të caktuara që lidhen me ndonjërin nga sëmundjet me rëndësi globale, programet dhe kontrollet sistematike nëpër shkolla, sidomos në sferën e stomatologjisë, shërbimet e vaksinimit, ambulancat shkollore, programet arsimore dhe shkencore në mediumet elektronike, broshurat, programet e ndryshme të trajtimit të grupeve të caktuara të popullatës, programet promovuese të shëndetit për nëna dhe fëmijë, të mbështetura shpeshherë edhe nga partnerët dhe donatorët e jashtëm, janë vetëm disa nga aktivitetet që ofruesit e shërbimeve shëndetësore bëjnë për edukimin e popullatës dhe promovimin e jetës së shëndoshë, natyrisht në funksion të parandalimit të sëmundjeve.

Fatkeqësisht, sot ne e kemi një numër të konsiderueshëm të profesionistëve shëndetësorë me edukim bazik shëndetësor dhe specialistik, që janë të papunë. Me rastin e marrjes së specializimeve, atyre u ndërpritet kontrata, nëse kanë pasur kontratë pune me institucionet bazë dhe lidhet kontrata me Ministrinë e Shëndetësisë derisa janë specializantë në procesin e specializimit. Në momentin e kryerjes të specializimit, respektivisht të diplomimit, u pushon kontrata dhe u ndërpritet marrëdhënia e punës, respektivisht pagesa. Nëpërmjet formave të

konkurrimit, ata varësisht prej nevojave të institucioneve shëndetësore dhe rekrutohen rishtas dhe punësohen nëpër institucione.

Të nderuar deputetë,

Një mosplanifikim i drejtë i nevojave të profileve të caktuara ka bërë që sot ne kemi mungesa në profilet specifike të profesionistëve shëndetësorë, e në anën tjetër kemi edhe grumbullime në profilet e caktuara. Problemi i stomatologëve është një problematikë me specifika të veçanta, por duhet pranuar që për shkak të specifikave që kanë, ata shpeshherë janë gjetur në pozita më të volitshme në raport me profesionistët tjerë për shkak të mundësisë së ushtrimit të veprimtarisë në sektorin privat.

Ju them që për shkak të mungesave buxhetore dhe limiteve në numrin e të punësuarave, ne sot e kemi një numër të madh të profesionistëve shëndetësorë të cilët nuk po mund t'i sistemojmë, andaj edhe për këta 11 kolegë, sa i theksoni, ende nuk e kemi një...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë?

NUREDIN IBISHI: Mirëpo, këtu në kontratën e punës për këta specialistë që adresohet, në këtë moment jo, por ka të bëjë me mandatin tjetër, në pikën 10, nën a) si kushte specifike kërkohen që pas kompletimit të suksesshëm të trajnimit profesional dhe regjistrimit si mjek i licencuar të punojnë në orar të plotë për 5 vjet pa ndërprerje për Shërbimin Publik të Kosovës, apo t'i kthejnë të gjitha pagat e fituara si specialistë, domethënë kjo është kontratën e tyre të punës, nuk po di tash...

KRYESUESI: Në rregull! Deputeti Bislimi, pyetje për ministrin Abdullah Hoti. Dëshironi ta bëni pyetjen? Zotit Bislimi fjalën!

BESNIK BISLIMI: Në fakt, pyetja ime daton që prej 10 shkurtit të këtij viti dhe është pak e pakuptimtë, sepse nuk duhet të zgjasë kaq shumë dhe ne të mos kemi mundësi ta shtrojmë pyetjen. Po jua rikujtoj se është koha e pyetjeve parlamentare, e 80% e Qeverisë nuk është këtu. Ne pyetjet nuk ia bëjmë njërën-tjetrit, por ua bëjmë ministrave dhe është më mirë të mendojmë ta gjejmë një mekanizëm që i obligon ministrat të jenë këtu, të paktën gjatë periudhës së pyetjeve parlamentare, përndryshe gjithë ky segment i debatit parlamentar kur na shtrojmë pyetje është i pakuptimtë. Pyetja ime ka të bëjë me vendimin që ka marrë Ministria e Financave më 5 shkurt për faljen e borxheve, që datojnë para vitit 2008. Edhe unë kam dashur ta di prej ministrit që ky vendim që mund të ketë implikime buxhetore, a i ka paraprirë atij vendimi të një analize, që tregon se sa do të jetë impakti buxhetor, përveç në nivelin qendror, sa do të jetë impakti në shëndetin financiar të ndërmarrjeve publike, për të cilat janë falë borxhet dhe për komunat, në emër të të cilave ministri i ka falur borxhet, se është e palogjikshme që ministri i Financave të dalë e t'i falë borxhet e tjetërkujt.

Edhe kam dashur ta di prej ministrit se cili është kanali nëpërmjet të cilit faljen e borxheve doganore e lidh me ndërprerjen e ikjeve nga Kosova, sepse u krijua një përshtypje që njerëzit po ikin prej turpit që nuk po mund t'ia paguajnë shtetit barrën doganore, ose obligimin doganor dhe

se ministri nëpërmjet faljes së këtyre obligimeve po i mban ata në Kosovë. Unë do ta bëj këtë pyetje prapë kur ministri ta shohë të dinjitetshme të paraqitet këtu për pyetje.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bislimi, e keni edhe një pyetje, në qoftë se dëshironi edhe këtë ta bëni për të njëjtin ministër, ose e kanë përsëritur dy herë. Në rregull! Atëherë deputeti Mytahir Haskuka, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

MYTAHIR HASKUKA: Faleminderit, kjo prej sesionit të kaluar, domethënë e keni me siguri edhe të shënuar, por prapë po e lexoj: Çështja, sipas raportimit të mediave, Inspektorati për Punë ka konstatuar se një bankë e ka reduktuar numrin e punëtorëve për më shumë se 10%, pra ka bërë shpëputje kolektive të kontratave të punëtorëve, por këtë e ka bërë me largimin individual nga puna, duke mos i respektuar të drejtat e punëtorëve dhe duke bërë presione për dorëheqje dhe diskriminim të punëtorëve gjatë largimit nga puna. Pyetja: Duke u bazuar në konstatimet e Inspektoratit të Punës dhe raportimin e mediave për presione, shantazhe dhe kërcënime ndaj punëtorëve për të kërkuar dorëheqjen e tyre, në mënyrë që t'u shmangen obligimeve ligjore, a do të ndërmarrë ministria ndonjë veprim konkret për ta hulumtuar monitorimin e të drejtave të punëtorëve që punojnë në korporatat e mëdha në Kosovë në përgjithësi dhe në mënyrë specifike a do të ndërmerrni ndonjë veprim konkret lidhur me largimet nga puna nëpër këto banka?

KRYESUESI: Zoti Abrashi, e keni fjalën!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: I nderuar kryesues!

Kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Ministra,

Deputetë,

Faleminderit për pyetjen!

Inspektorati i Punës në mënyrë permanente bën inspektimin nëpërmjet të cilit bën mbikëqyrjen dhe respektimin e të drejtave ligjore të punëtorëve, si dhe ndërmerr hapa që këto të drejta të respektohen nga punëdhënësit. Sa për informatë, gjatë vitit 2014, Inspektorati ka realizuar 9 337 inspektime, nga të cilat 5 974 kanë qenë të rregullta dhe 2 715 kanë qenë inspektime të përsëritura, kur inspektorët kanë evidentuar të meta në respektimin e ligjeve gjatë inspektimeve të rregullta, sikur edhe i kanë dhënë vërejtjet e tyre për eliminimin e tyre. Me rastin e riinspektimeve kanë verifikuar dhe janë eliminuar këto të meta. 488 inspektime me kërkesë të palëve, të cilët i janë drejtuar Inspektoratit të Punës për mbrojtjen e të drejtave të tyre, që kanë konsideruar se janë shkelur, si dhe 160 inspektime të përbashkëta me organet tjera, të cilat bëjnë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve.

Në ndërkohë, me qëllim të ngritjes së vetëdijes së punëdhënësve që t'i respektojnë të drejtat e punëtorëve, Inspektorati i Punës, në bashkëpunim me organizatat tjera të punës dhe odat ekonomike, organizon fushata vetëdijesuese dhe sensibilizuese. Fokus i veçantë i këtyre fushatave është informaliteti, punëtorët pa kontrata pune, siguria dhe shëndeti në punë. Si pasojë e kësaj fushate, nga inspektimet me intensitet të lartë dhe me sanksione më të ashpra kanë bërë që Inspektorati të bëjë inspektime të përditshme me të gjitha kapacitetet, gjithnjë ta ketë prioritet mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve bazuar në ligj, andaj edhe largimin pa puna pa baza ligjore, diçka që trajtohet në përditshmëri nga inspektorët, kurse bazuar në këtë vit, në mandatin e ri të

Ministrisë ne do t'i vazhdojmë këto inspektime nëpërmjet fushatave vetëdijesuese të inspektimeve më të rregullta.

Unë vetë kam marrë përsipër të caktoj targete më të mëdha për Inspektoratin nëpërmjet një analize dhe hartimit të një strategjie më të veçantë, sikur edhe nëpërmjet fushatave vetëdijesuese. Në këtë rast mendoj ta hapim edhe një linjë telefonike anonime, apo një linjë nëpërmjet internetit, ku punëtorët do të kishin mundësi t'i raportojnë abuzimet potenciale që mund t'i kenë. Kjo si fazë parandaluese.

Çka është shqetësues, është numri i inspektorëve. besoj që me rishikimin e buxhetit, ndoshta këtë vit, por edhe në vitin e ardhshëm, ne do të kemi mundësi ta rritim numrin e inspektorëve, pasi në disa komuna me një inspektor është e pamundur të monitorohen dhe të mbikëqyren të gjitha kompanitë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputet, pyetje shitesë?

MYTAHIR HASKUKA: Faleminderit për informatat, ishin shumë të mira, po mendoj në përgjithësi, por pyetja ime specifike ka qenë për korporatat e mëdha në Kosovë, se ne e dimë se Inspektorati i Punës shkon nëpër shitoret dhe ndërmarrjet e vogla, të cilat e kanë një apo dy punëtorë, por në rastin e specifikuar ose çështjen e ngritur nga unë dhe nga mediat ka qenë pikërisht mosrespektimi i këtyre të drejtave të punëtorëve nga korporatat e mëdha dhe në atë aspekt këtu unë fola për bankat, por ndoshta këtu hyjnë edhe korporatat tjera, të cilat operojnë në Kosovë, e të cilat janë më të mëdha dhe që kanë në njëfarë aspekti punëtorët me avokatët e tyre, gjë që në këtë rast ka qenë evidente: Lidhur me këtë, a do të bëhet diçka nga Inspektorati? Kjo ka qenë pyetja, faktikisht.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ministër, dëshironi të përgjigjeni?

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit edhe një herë!

Ideja është që nëpërmjet sensibilizimit dhe krijimit të një linje anonime, të cilën po mendojmë ta vendosim gjatë këtij viti, qoftë nëpërmjet telefonit, qoftë nëpërmjet internetit, t'i prekim edhe korporatat në këtë rast. Nuk do të kisha hyrë në detaje se cilat korporata, pa dashur ta cenoj punën e tyre dhe vetë punën e Inspektoratit, pasi ata edhe sot ndoshta janë në terren, dhe besoj që janë në terren, por është ideja që nëpërmjet fushatave sensibilizuese nëpërmjet kërkesave më të mëdha prej vetë meje ndaj Inspektoratit, të arrijnë që t'i eliminojmë këto probleme.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Dërguti, pyetje për kryeministrin Mustafa.

AIDA DËRGUTI: Zoti kryeministër!

Më 3 shkurt, në një konferencë të jashtëzakonshme tuajën deklaruat se Aleksandër Jablanoviq më nuk është pjesë e Kabinetit tuaj. Në lidhje me këtë, po ju citoj: "Sa i përket ministrit Jablanoviq, ju njoftoj se nga sot ai nuk është pjesë e Kabinetit tim qeveritar". Pyetja ime është: Pse nuk e keni publikuar ende vendimin tuaj për shkarkimin e ministrit Jablanoviq?

KRYESUESI: Zoti Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zonja deputete!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Nuk është gjë e zakonshme që ne t'i publikojmë vendimet e kryeministrit. Ne i publikojmë vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës ditën që unë kam deklaruar, atë ditë është shkarkuar ministri Jablanoviq, dhe ky ka qenë akt i përfunduar. Ne nuk kemi konsideruar që duhet të bëjmë akt tjetër, sepse nuk i publikojmë vendimet individuale. Publikohen vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Dëshironi pyetje shtesë, zonja Dërguti?

AIDA DËGRUTI: Meqë prej momentit të shkarkimit Lista serbe më nuk u kthye në Kuvendin e Kosovës, a nënkupton kjo se juve ju janë parashtruar kushte të reja nga Lista serbe dhe nëse po, cilat janë ato?

KRYESUESI: Zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Tani kjo është pyetje tjetër krejtësisht, mirëpo për shkak të korrektësisë unë po përgjigjem. Nuk e kemi asnjë kusht të paraqitur për kthim. Unë kam kërkuar nga ministrat e Listës që të vijnë dhe të diskutojmë me ta, por nuk kanë ardhur akoma. Kanë paralajmëruar se do të vijnë të bisedojmë lidhur me kthimin e tyre, por kushte nuk kemi dhe kushte nuk pranojmë asnjë kusht, sepse edhe ata do të kenë kushte të njëjta sikur të gjithë ministrat tjerë. Nuk mund që për një komunitet të aplikojmë kushte tjera, për komunitete e tjera kushte tjera, ose për shqiptarët tjera, për serbët tjera. Kushtet janë të njëjta. Ato që janë të parapara me Ligj dhe me Kushtetutë dhe natyrisht ato që ne i kemi paraparë me marrëveshje për koalicionet. Me marrëveshje nuk ka specifika të veçanta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Baftija, pyetje për ministrin Rrahmani.

BESA BAFTIJA: Faleminderit, kryesues!

Unë pyetjen e kam parashtruar në seancën e kaluar. Ministri nuk ka qenë këtu i pranishëm, por pasi tani është këtu, unë do ta bëj. Pyetja ime ka qenë lidhur me citostatikët. Ministri në muajin e kaluar e ka vizituar Klinikën e Onkologjisë, ku ka thënë se kjo klinikë do të jetë prioritet i Ministrisë së Shëndetësisë. Pyetja ime konkrete është: A do të ketë citostatikë për aq sa janë nevojat e Klinikës së Onkologjisë? Faleminderit!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit!

Përafërsisht kam dhënë përgjigje lidhur me citostatikët dhe Klinikën e Onkologjisë edhe më herët, por po e përsëris që nevojat e Klinikës së Onkologjisë për citostatikë dhe për përmbushjen e listës esenciale të citostatikëve janë rreth 9 milionë të planifikuar. Ne tash për tash i kemi 6 milionë për citostatikë dhe duhet të shikohet që shfrytëzimi racional i citostatikëve të bëhet konform planit që e kishin hartuar kolegët në Klinikën e Onkologjisë dhe duhet të shikohet që disa nga citostatiakët për të cilët nuk ka pasur oferta, ne ta gjejmë formën dhe t'i blejmë. Janë edhe një numër i citostatikëve që duhet të eliminohen nga lista ekzistuese dhe besojmë që deri në fund të vitit ne do të arrijmë t'i përmbushim të gjitha nevojat e qytetarëve tanë për citostatikë për pacientët e Onkologjisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Baftija, keni pyetje shtesë?

BESA BAFTIJA: Faleminderit për përgjigjen!

Zoti ministër, a jeni në dijeni që në Klinikën Onkologjike punët nuk janë ashtu siç ju keni deklaruar gjatë asaj vizite dhe siç e keni parë. Jemi në dijeni edhe në bazë të një analize që e ka bërë “Preport”, aty bëhet kontrabandë e madhe edhe me ata pak citostatikë që janë aty. Në bazë të kësaj analize, apo në bazë të këtyre të dhënave, ka citostatikë të cilët janë të dalë nga klinika dhe janë gjetur nëpër farmacitë private, është larguar banderola, e i njëjti me numër serik është vërtetuar se ka dalë nga Klinika e Onkologjisë.

KRYESUESI: Zoti Ministër, e keni fjalën!

MINISTRI IMET RRAHMANI: Zonja deputete,

Unë në vizitën që e kam bërë në Klinikën e Onkologjisë kam parë aty është një ekip i shkëlqyeshëm i mjekëve, që ata me marrëveshje kanë bërë protokollin e trajtimit e pacientëve dhe e kanë nënshkruar të gjithë mjekët dhe janë duke iu përmbajtur strikt e me rigorizitet asaj për çka janë marrë vesh dhe e kam vërejtur se ekzistojnë katër hallka të evidentimit të përdorimit të citostatikëve prej hyrjes deri te dhënia te pacienti.

Por, rastet që po i cekni, besoj që do të jenë objekt hulumtimi i Inspektoratit të Shëndetësisë dhe Farmaceutikëve, e nëse gjenden ne do të marrim masa, por unë besoj që nga ajo që kam parë në organizimin që kanë bërë në klinikë tash janë vendosur punët në binarë të duhur dhe ne duhet të inkurajojmë ata për punën e madhe që janë duke bërë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Visar Ymeri, pyetje për ministrin Stavileci. Ministri nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetje, zoti Visar?

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Kjo është pyetje është për një kohë të gjatë, është dorëzuar më 10 shkurt dhe është lexuar edhe një herë në seancë, kur nuk ka qenë ministri këtu. Po e përsëris prapë vetëm sa t’ia kujtoj se cila është pyetja, meqenëse është hera e fundit që kam të drejtë ta shtroj në seancë.

Ka të bëjë me tenderin edhe hapjen e ofertës për termocentralin “Kosova e Re”, ose për projektin “Kosova e Re”, që është bërë edhe oferta ose një ofertues në të nga kompania amerikane “Control Global”. Në raportime të shumta është thënë që ka qenë një tender njëburimor, domethënë, që nuk ka një kompani tjetër dhe, nga Qeveria edhe nga ministri nuk është dhënë asnjëherë në mënyrë të qartë dhe transparente se si ka shkuar ky proces dhe cilat janë kushtet cilat mund të drejtohet ky projekt në të ardhmen.

Pyetja ime për ministrin ka qenë se sa do të kushtojë i tërë projekti, pra a ka ndonjë vlerë të përgjithshme për projektin dhe çfarë norme të kthimit të investimeve e ka kërkuar ose ka propozuar “Control Global” nga ky projekt?

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri s’është këtu. Ndoshta, të gjithë kemi nevojë të informohemi për këtë çështje. Deputetja Haxhiu, pyetje për ministrin Hajredin Kuçi. Ministri nuk është këtu. A dëshironi, zonja Haxhiu, ta merrni fjalën?

E ka fjalën zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Atëherë, pyetja për ministrin e Drejtësisë, Hajredin Kuçi ka të bëjë me Gjykatën Speciale. Pavarësisht faktit, që ministri i Drejtësisë nuk është këtu, tashmë është e qartë që Gjykata Speciale apo amendamentet që janë dërguar në Gjykatën Kushtetuese, përveç që njollosin luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e cenojnë edhe atë pak sovranitet gjyqësor që kishim, duke krijuar kështu sistem paralel nga Gjykata Themelore deri te Gjykata Supreme dhe një sistem ose organ paralel të Gjykatës Kushtetuese dhe Ombuspersonit.

Për këtë arsye, sigurisht që ne si subjekt politik do ta kundërshtojmë fuqishëm me të gjitha mjetet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demaku, pyetje për ministrin Hyseni. A dëshiron ta bësh pyetjen, Fadil? Zotit Demakut e ka fjalën.

FADIL DEMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Do ta bëj pyetjen pasi që nuk ka më mundësi të parashtrohet pyetja në një seancë të ardhshme.

Çështja ka të bëjë me kadetët që kanë përfunduar studimet në Akademinë Policore të Turqisë. Në marrëveshjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, me kadetët e realizuar më 2008, në kontratë te pika 2, shkruan: “Ministria e Punëve të Brendshme ose cilido pasardhës i saj, menjëherë pas marrjes së dëshmisë së përfundimit të studimeve, duhet t’i ofrojë përfituesit kontratë të rregullt pune në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe jo më vonë, se 3 muaj kalendarik.”

Të gjithë kadetët kanë hyrë në vitin e dytë që kanë përfunduar studimet në Turqi. Kanë bërë përpjekje të vazhdueshme në institucione për t’u implementuar kontrata, por ende nuk është arritur asgjë.

Unë do t’i citoj pjesët e një letre të datës 24 maj 2014, ku ish- ministri Bajram Rexhepi i drejtohet drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, citoj: “Siç jeni të informuar, Qeveria e Republikës së Turqisë, është duke mbështetur institucionet e Republikës së Kosovës në forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale në fushën e sigurisë. Nga takimi që kam pasur me delegacionin e Këshillit të Sigurisë së Republikës së Turqisë, më është kumtuar shqetësimi i tyre për mos inkuadrimin e kadetëve të shkolluar me financimin dhe përkrahjen e tyre në institucionet arsimore në Republikën e Turqisë, andaj si institucione do të tregojmë se jemi partnerë seriozë.” përfundon citati.

E lexova këtë, për ta kuptuar të gjithë, sepse ata kanë qenë të vetëdijshëm se kjo çështje kërkon zgjidhje. Deri më tani, Ministria e Punëve të Brendshme nuk i është përmbajtur kontratës.

Çfarë do të ndodhë me këta kadetë?

A do të mbesin edhe më tutje jashtë institucioneve apo do të sistemohen në bazë të kontratës së nënshkruar, sepse po të mos ishte ajo kontratë e nënshkruar, nuk besoj se do të kishte pasur interesim nga ata kadetë, që të vazhdojnë për pesë vjet me radhë studimet në Republikën e Turqisë, në fushën profesionale të caktuar dhe që të mos ketë kurrfarë garancie?

Ata kanë shkuar atje në bazë të kontratës dhe besoj që ajo duhet të përmbushet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gashi, pyetje për ministrin Imet Rrahmani.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Pyetjen e kam shtruar para dy javësh, gjithsesi, unë po e përsëris.

Duke marrë parasysh se Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në vitin 2005 ka dhënë në shfrytëzim tokën për ndërtimin e Qendrës Kardiale afër Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, duke marrë parasysh se kontrata skadon në muajin dhjetor të vitit 2015 dhe, po ashtu duke marrë parasysh që nuk është arritur realizimi i kësaj kontrate, kohëve të fundit aty shihen zhvillime dhe planifikohet që të ndërtohet, të hapë aktivitetin e tij Spitali i Përgjithshëm Amerikan në Kosovë.

Cilat janë masat që Ministria juaj ka ndërmarrë? A ka shkuar Inspektorati Shëndetësor për të parë se çfarë po punohet aty, sepse dhënia në shfrytëzim e hapësirës publike është bërë me destinim specifik, qendër kardiale, jo spital të përgjithshëm? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Rrahmani, e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, zoti Gashi, për pyetjen që e keni ngritur.

Pra, është një çështje e rëndësisë së veçantë, them kështu, për shkak të kompleksitetit të problematikës, aty është ndërtuar një spital, i cili ende nuk është funksional dhe, Inspektorati shëndetësor nuk ka pasur arsye të shkojë të inspektojë, sepse nuk kemi të bëjmë me veprimtari shëndetësore ende, aty.

Jemi të njoftuar edhe me lejen që ua ka dhënë Komuna e Prishtinës dhe me vendimin që ka nxjerr Qeveria e Kosovës për dhënien e lejes së ndërtimit të atij spitali dhe, ju garantoj që do të veprojmë duke u bazuar në dispozitat në fuqi të ligjit.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gashi, a dëshironi pyetje shtesë?

ARBEN GASHI: Faleminderit, zoti ministër!

Atëherë, meqë nuk ka filluar aktiviteti aty, ju si Ministri e jepni licencën e ushtrimit të aktivitetit- A ka kërkesë në Ministrinë e Shëndetësisë, për hapjen e Spitalit të përgjithshëm, sepse Komuna e Prishtinës ka dhënë me qëllim, destinim specifik – Spital Kardiologjik për çështje të zemrës dhe iu ka dhënë disa mjekëve specialistë me renome botërore shqiptarë, që të ushtrjnë këtë aktivitet dhe t'i mbrojnë interesat e qytetarëve të Kosovës, duke ofruar edhe shërbime falas dhe plot elemente të tjera, që ka kontrata e Komunës së Prishtinës e vitit 2005 me Qendrën Kardiale të Kosovës, e cila është nënshkruar para dhjetë vjetësh. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Spitali në fjalë ka licencën për veprimtari në Ajvali dhe është duke vazhduar punën. Është bërë një kërkesë në Ministrinë e Shëndetësisë nga i njëjti spital për ndryshim të veprimtarisë dhe ende nuk kam marrë përgjigje nga kompetentët e Ministrisë së Shëndetësisë. Dhe, besoj që përgjigja do të jepet konform asaj çka është që shkruan në ligj dhe dispozitave në fuqi.

Problemi i Komunës së Prishtinës me lejen, ose mosshfrytëzimin, ose mospërmbylljen e kriterëve të kontratës, besoj që është problematikë e Komunës së Prishtinës me qiramarrësin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kadrijaj, pyetje për ministrin Arban Abrashi.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti është aprovuar në maj të vitit të kaluar. Edhe pse nuk ka qenë ligj i kënaqshëm dhe i pritur nga pensionistët, megjithatë me kërkesë të ministrit, sepse nga ky ligj po varen shumë marrëveshje me rajonin dhe më gjerë, ne e kemi aprovuar këtë ligj.

Ministër, sa po zbatohet dhe a ka filluar të zbatohet, cilat nene kanë filluar të zbatohen nga ky ligj dhe, a ka ndonjë marrëveshje për pensionistët, të cilët punojnë në shtete të jashtme apo edhe për punë sezonale me shtetet tjera të rajonit?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!

Kryeministër,

Ministra,

Deputetë,

Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe kodifikimi i skemave pensionale, të cilat janë zbatuar në kontinuitet janë si pensionet bazë, pensioni kontributiv, pensionet e personave me paaftësi të përhershme dhe pensionet e parakohshme.

Me këtë ligj, ashtu siç jeni në dijeni, nga 1 janari është paraparë të fillojë implementimi i dy skemave të reja: pensionet invalidore, neni 11 dhe pensioni familjar, në nenin 12, sikurse dhe kategorizimi i pensioneve kontributdhënëse.

Tek kjo fazë, pensionet invalidore dhe pensionet familjare, sikur dhe kategorizimi i pensioneve kontributdhënëse, grupet punuese disa ministrore janë duke punuar në përmirësimin e infrastrukturës ligjore, diçka e cila duhet të përmirësohet dhe besoj në gjashtëmujorin e parë do të kemi përmirësim dhe përmbylljen e të gjithë nevojave dhe akteve nënligjore, që të implementohen këto skema.

Kurse, tek marrëveshjet me jashtë, kemi filluar në disa takime, në bashkëpunim me Ambasadën zvicerane, hartimin dhe plotësimin e pyetësorit, diçka që është punuar më herët gjatë viteve të kaluara. Ne jemi duke punuar vazhdimisht në këtë pyetësor dhe besoj që deri në fund të marsit

do ta dërgojmë pyetësin e plotësuar tek autoritetet zvicerane, në mënyrë që të shikojmë se çka mund të përfitojnë qytetarët tanë, bashkatdhetarët tanë në Zvicër.

Realisht, ne besojmë që deri në fund të muajit, do t'i kryejmë obligimet tona, sa i përket plotësimit të pyetësorëve. Është një punë shumë e madhe, që po bëhet në disa ministri dhe agjenci tjera, në Ministri të Shëndetësisë, Trust Pensional, e kështu me radhë, sikurse edhe në Ministrinë tonë dhe pastaj, mbetet tek autoritetet zvicerane ose për pyetje shtesë, apo të shikojmë se si të veprojmë tutje.

KRYESUESI: Faleminderit! A ke pyetje shtesë, zonja Kadrijaj?

TIME KADRIJAJ: Po, për disa pyetje ministri veç dha sqarim, sepse të vetmet ndryshime kozmetike, që i janë bërë ligjit, ashtu sa na është lejuar për shkak se gjithmonë kemi punuar me presionin se aty nenet e caktuara, të cilat kanë kosto buxhetore nuk guxojnë të preken, kanë qenë Ligji i pensioneve familjare dhe invalidore.

Pse ne e kemi shtyrë këtë çështje, ka qenë sepse është shumë e pakuptimshme, kur në një familje kur vdes kryefamiljari, familja mbetet pa asnjë mbështetje financiare. Dhe, është shumë me rëndësi, që bile këto nene për pensionet familjare dhe pensionet invalidore, të fillojnë të implementohen shumë shpejt.

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit!

Është shumë e vërtetë, është diçka në të cilën po punojmë konkretisht në vazhdimësi. Nenet të cilat i përmendët, kanë një kosto të lartë buxhetore, kosto e cila nuk është parashikuar në buxhet, prandaj edhe po shikojmë mënyrat se si të arrijmë deri te kjo kosto.

Jemi duke bërë përllogaritjet dhe vlerësohet se mund të shkojë 30-40 milionë implementimi i këtyre neneve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muharremaj, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

BALI MUHARREMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Unë i kam paraparë dy pyetje për kryeministrin e Kosovës.

Pyetja e parë ka të bëjë: A është ndërmarrë ndonjë veprim konkret nga Qeveria juaj për zhvillimin ekonomik dhe për hapjen e vendeve të reja të punës, gjë e cila do të ndërpriste sadopak këtë shpërngulje të qytetarëve nga vendi ynë?

Dhe pyetja e dytë është - në seancën e Kuvendit të Kosovës, të datës 2 shkurt 2015, është miratuar Rezoluta për pengimin e migrimit ilegal të qytetarëve të Kosovës, ku njëra nga pikat e kësaj Rezolute ka qenë edhe krijimi i fondeve për pengimin e migrimit legal.

Pyetja për kryeministrin është: A është krijuar Fondi për pengimin e migrimit ilegal, sa është ndarë ky në këtë fond dhe kur do të fillojë të implementohet në jetën e përditshme? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, deputet Muharremi.

Sa i përket pyetjes së dytë lidhur me formimin e fondit, ne nuk kemi themeluar fond, sepse fondi i tillë duhet të themelohet këtu në Kuvend, për arsye se Kuvendi duhet të vendosë lidhur me plotësimin dhe ndryshimin e buxhetit. Nuk e kemi iniciuar akoma çështjen e këtij fondi.

Ndërkaq, sa i përket veprimeve konkrete, që Qeveria po i ndërmerr për zhvillimin ekonomik, mund të them se këto veprime mund të ndërmerren vetëm në suaza të planit qeverisës, në të vërtetë programit qeverisës, të cilin ne e kemi aprovuar e të cilin ia kemi adresuar edhe Kuvendit, që ta diskutojmë edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ndër masat më praktike të cilat ne mendojmë t'i ndërmarrim në mënyrë që të hapim vende të punës dhe të nxisim sektorin privat të ekonomisë, është themelimi i Fondit zhvillimor. Ne e kemi themeluar një grup profesioniste në Qeverinë e Republikës së Kosovës, e cila do ta konceptojë themelimin e Fondit zhvillimor, në të cilin ne do t'i përfshijmë mjetet nga donatorët, t'i kemi disa mjete. Do të përfshijmë mjete nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, të cilat janë të lira dhe të cilat mund t'i orientojmë në zhvillimin ekonomik, mjete bankare të cilat mund t'i sigurojmë që do të jenë me kushte më të lira dhe mjete nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Jemi marrë vesh që të bëjmë ndryshimin e Ligjit për investime të huaja, në mënyrë që investimet e huaja t'i realizojmë nëpërmjet partneritetit strategjik dhe të sigurojmë kushte shumë më të shpejta të investimeve dhe me vendimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak të transparencës në këto investime.

Jemi duke punuar tani në ndarjen e subvencioneve të grandeve për bujqësi, në mënyrë që ta nxisim e ta stimulojmë sektorin e bujqësisë. Është biseduar me Bankën Evropiane për Zhvillim për kredi të buta të kësaj banke, veçmas për mbështetjen e bizneseve të grave dhe bizneseve të rinjve.

Një marrëveshje është bërë për biznese të grave me TEB-in ndërmjet Bankës Evropiane për Zhvillim dhe TEB-it dhe, po ashtu do të punojmë në ndryshimin e disa politikave fiskale, në mënyrë që të sigurojmë që firmat të cilat themelohen rishtas, të lirohen në vitet e para nga tatimi në fitim, përkatësisht tatimi në të ardhura të korporatave, varësisht nga shuma e investimeve dhe varësisht nga vendet e punës të cilat hapen.

Mundësi të tjera, tani për tani nuk shoh. Janë edhe disa masa, për të cilat ne më konkretisht do t'ju njoftojmë dhe do të diskutojmë.

KRYESUESI: Faleminderit! A ke pyetje shtesë, zoti Muharremaj?

BALI MUHARREMAJ: Po, faleminderit, zoti kryeministër!

Plotësisht pajtohem me pyetjen e parë për krijimin e vendeve të reja të punës dhe për zhvillim ekonomik, mirëpo derisa Rezoluta ka kaluar në këtë Kuvend, me shumicë nga të gjitha partitë politike, atëherë kjo është vendim i Qeverisë që duhet ta marrë një vendim e ta kthejë në Parlament.

Unë këto dy pyetje do t'i ruaj, pas tre muajsh do t'i bëj edhe njëherë. Faleminderit !

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Kada-Bujupi, pyetje për kryeministrin Mustafa.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Sundimi i ligjit dhe lufta kundër korrupsionit janë çështje të cilat po e pengojnë ecjen përpara të Kosovës.

Mirëpo, në memorien kolektive të qytetarëve tanë, korrupsioni daton qysh herët dhe nis me Fondin e 3%-shit, për të cilin ju keni qenë përgjegjës. Kemi indikacione që në këtë procesin e themelimin e Gjykatës Speciale, jeni duke negociuar që ky fond të mos hetohet dhe të mos jetë pjesë e këtyre hetimeve të cilat po ndodhin.

Pyetja është: A jeni i gatshëm që ta thërrisni, drejtësinë që të merret me hetimin e këtij fondi, në mënyrë që të bëhet transparent?

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Kjo pyetje është jashtë rendit të ditës, sepse kjo pyetje nuk ka qenë e shtruar. Por, që të mos mendoni ju që po i iku përgjigjes, unë po ju them se asnjë negociim i Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të strukturave qeverisëse të Kosovës nuk ka me Gjykatën Speciale, sepse Gjykata nuk është themeluar akoma, Gjykata trajton çështjet, të cilat i ka hapur Këshilli i Evropës në bazë të raportit të Dik Martit.

Prandaj askush nuk mund as të shtojë as të heqë nga ajo që është hetuar dhe nga ajo që ka qenë objekt i kësaj gjykate. Të gjitha të tjerat janë paragjykime tuajat, por çdonjëri prej nesh të cilët kemi punuar në një periudhë të caktuar kohore, jemi në gjendje që ta marrim përgjegjësinë plotësisht për punën tonë. Edhe unë e marr përgjegjësinë për punën time që e kam bërë, kështu që fare mos u brengos për atë

punë, kur të hapet kjo çështje, është hapur disa herë, është diskutuar, përgjegjësia është kështu që, nuk është ky objekt, ose është, ose s'është, nuk është çështje jona. Gjykata Speciale do të merret me çështje të cilat janë hetuar dhe me çështje të cilat ajo do t'i hetojë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bujupi ka pyetje shtesë.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: I nderuar, kryeministër,

Ky është një dokument, të cilin ju e keni quajtur "bon" asokohe, realisht e keni lëshuar për bashkatdhetarët tanë, të cilët kanë dhënë miliona euro në emër të letrave me vlerë. E ka datën korrik 1998, më ka ardhur nga Gjermania, nga aktivistë, të cilët prej atje kanë derdhur fonde e fonde me kërkesë tuajën dhe, këta qytetarë kanë nevojë të dinë se ku kanë shkuar këto mjete, kanë nevojë të ketë transparencë dhe ka nevojë t'ju jepet një përgjigje, sepse këto letra me vlerë të ashtuquajtura nga ju, ose "bona" qysh e keni përdorur fjalën, në fakt u janë dhënë duke u premtuar, se në Kosovën- shtet, këto para do t'ju kthehen.

Prandaj, besoj që ju keni nevojë të jepni shumë sqarime para opinionit, sidomos tani kur jeni kryeministër i këtij vendi dhe, sidomos tani kur e keni gojën plot sundim të ligjit dhe luftë kundër korrupsionit. Dhe, siç e thashë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën kryeministri Isa Mustafa.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Ato vërtetë janë bona të cilët janë përdorur atëherë për të mbledhur mjete për pavarësinë e Kosovës. Mjetet janë shfrytëzuar për qëllime të caktuara, për ato mjete i është dhënë raport Kuvendit të Republikës së Kosovës, atëherë, kanë qenë shumë transparente. Kurrkush nuk ka garantuar, që mjetet do t'i kthehen dikujt, sepse nuk janë marrë mjete për t'u kthyer, ashtu siç nuk u kthehet jeta atyre që e kanë dhënë jetën për pavarësinë e Kosovës. Mjetet janë shfrytëzuar dhe në ato "bona", do të thotë nuk ka obligim asnjë qeveri që t'ua kthejë atyre që kanë kontribuar për pavarësinë e Kosovës, sepse të gjitha mjetet... dhe jashtë nuk... po, transparenca është dhënë, ti Donikë, për transparencë tjetër, kërkojeni ju. Transparenca i është dhënë atij Kuvendi edhe është kryer puna e transparencës.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Deputeti Rexhep Selimi, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, kryesues!

Zoti kryeministër,

Jemi dëshmitarë që muajt e fundit mijëra qytetarë kanë lëshuar detyrimisht vendin, duke migruar ilegalisht në shtetet e Bashkimit Evropian.

Jeni deklaruar si në vijim, po mundohem t'ju citoj, ju thoni: "Tani duhet të punojmë të gjithë ne, sepse të gjithë ne mund të punojmë këtu në Kosovë, se situata ekonomike nuk është e mirë, por nuk është një situatë ekonomike që nuk ka perspektivë, që nuk ka zgjidhje."

Pyetja ime është: A mund të na thoni, se çfarë keni bërë që qytetarët të kenë perspektivë, ashtu siç thoni ju dhe shpresë, për një jetë stabile ekonomikisht, pra, cila është zgjidhja që i referoheni ju?

KRYESUESI: Zoti kryeministër e ke fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Unë bëra përpjekje që të jap një pjesë të përgjigjes të kësaj pyetjeje, mirëpo unë respektoj pyetjen tuaj, deputet Selimi.

Ne do të përqendrohemi që përgjigjen tonë dhe kontributin tonë në krijimin e perspektivës së zhvillimit në Kosovë, ta bëjmë nëpërmjet implementimit të programit qeverisës. Dhe, unë do të kërkoj edhe kur ta diskutojmë këtë, që ta kemi përkrahjen e të gjithëve, që ta implementojmë këtë program, sepse është në dobi të gjithë qytetarëve dhe të gjithë deputetëve, pa marrë parasysh a jemi në pozitë apo opozitë.

Unë e kam thënë edhe kam thënë me vetëdije, sepse vlerësoj që resurset me të cilat ne disponojmë në Kosovë, janë të tilla, të cilat ne duhet t'i shfrytëzojmë edhe resurset natyrore edhe resurset njerëzore, sepse kemi një popullatë më të renë, t'i shfrytëzojmë edhe resurset kapitale, të cilat për fat të keq nuk janë të mira, por duhet t'i shtojmë dhe duhet të gjejmë mundësi të kreditimit dhe të financimit të zhvillimit ekonomik.

Ajo që ne i kemi dhënë prioritet është bujqësia, në mënyrë që atje të krijojmë vende të punës dhe të bëjmë formalizimin e punësimit informal, sepse kemi shumë punësim informal, i cili nuk ndihmon që njerëzit ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre nga puna dhe nga marrëdhënia e punës. Të punojmë në këtë fondin zhvillimor, të cilin dëshirojmë ta themelojmë menjëherë dhe të stimulojmë dhe të nxisim biznese të caktuara.

Po mundohemi të bëjmë marrëveshje për punësim stinor me disa prej vendeve, në mënyrë që ta kapërcejmë këtë periudhën e krizës, sa i përket numrit të madh të papunëve dhe, pastaj të kthehen njerëzit dhe të vazhdojnë me punë këtu dhe të bëjmë ndryshime në politikën fiskale, të cilat do të mundësojnë që të lehtësohen bizneset, veçmas me uljen e ngarkesave fiskale në vitet e para dhe, të bëjmë edhe shkallëzimin e TVSH-së, si dhe të lirojmë importimin e pajisjeve që janë të destinuara për prodhim, makinerisë dhe pajisjeve tjera, për të lehtësuar dhe për ta ulur koston e investimeve fillestare dhe fillimit të biznesit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A ke pyetje shtesë, zoti Selimi?

REXHEP SELIMI: Zoti kryeministër,

Kjo pyetje që unë e bëra dhe deklarimi juaj ka qenë më rastin e ngjarjeve të ikjes së njerëzve nga Kosova. Por, ish-kryeministri, zëvendësi juaj dhe ministri tani i Jashtëm, ka deklaruar, po mundohem ta parafrazoj, pra ka thënë se për një situatë të tillë e bën fajtor VLAN-in, bllokun VLAN, i cili bllok ka krijuar trauma dhe si pasojë e këtyre traumave tani kemi një situatë të tillë, pra i referohet situatës së ikjes së njerëzve.

Pyetja ime shtesë është kjo: a e pranoni përgjegjësinë që ua ngarkon ministri juaj dhe zëvendësi juaj, pra një përgjegjësi të tillë, apo e demantoni ministrin tuaj, pra i bie, a e ka thënë të vërtetën ministri Thaçi, kur e ka fajësuar VLAN-in e ndërkohë edhe juve, për shkak se numerikisht ju, zoti kryeministër, keni qenë pjesa më e madhe e atij blloku VLAN?

KRYESUESI: Zoti Mustafa, e ke fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Unë jam deklaruar edhe publikisht se nuk vlerësoj se këtë situatë e ka krijuar as VLAN-i dhe as që e krijuar themelimi i Qeverisë së re. Do të thotë, është një situatë reale, me të cilën nuk po ballafaqohemi vetëm ne në Kosovë, për fat të keq, ne jemi ballafaquar me fluksin më të madh të migrameve, në krahasim me vendet fqinje, sepse të dhënat po tregojnë që edhe kroatët kanë pasur diku mbi 25 mijë njerëz që kanë migruar, edhe pse është shtet i Bashkimit Evropian. Kemi edhe vende tjera në regjion, të cilat po ashtu kanë një migrim të madh duke përfshirë edhe Serbinë, kemi edhe në Shqipëri, kemi dhe në vendet tjera.

Dhe, unë vlerësoj se as VLAN-i dhe asnjë organizim yni nuk e ka shkaktuar këtë. Ajo që unë vlerësoj, zoti deputet Selimi, është që ne duhet të ulemi e ta bëjmë një vlerësim real, ta bëjmë një

hulumtim dhe ta shohim se cilat kushte socio-ekonomike apo kushte të tjera politike kanë shkaktuar që njerëzit tanë të marrim, të themi, këtë përmasë të migrimit nga Kosova. Çdo përgjigje tjetër e imja nuk do të ishte e bazuar, sepse nuk e kemi një analizë dhe një hulumtim, i cili mundëson që ne të japim përgjigje të saktë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri, pyetje për kryeministrin Mustafa.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Edhe kjo pyetje është tash e një kohë, është dorëzuar më 24 shkurt të këtij viti, po mirë që i erdhi radha që të marrë një përgjigje.

Po, ka të bëjë me një çështje e cila është diskutuar jashtëzakonisht shumë dhe e cila po mbetet temë, për shkak të rëndësisë së saj dhe për shkak të, si të them, mosveprimit karshi kësaj.

Më 21 janar, zoti kryeministër, siç ju kujtohet, minatorët e “Trepçës” e pezulluan grevën e tyre, me kushtin që pas një muaji, Qeveria e Republikës së Kosovës të sjellë ligjin, që do të merret me “Trepçën” dhe me të cilin ata të paktën, e kanë ndërprerë grevën duke shpresuar se do të përmbushet një kërkesë e vetme, që e kanë pasur në atë grevë, e ajo është që “Trepça” të shndërrohet në ndërmarrje publike.

Pra, pyetja ime është se deri ku keni mbërritur ju si Qeveri, që ta realizoni këtë kusht, rrjedhimisht të punoni në Ligjin për “Trepçën” dhe cili mendoni se do të jetë e dala nga ky ligj duke pasur parasysh kërkesën e minatorëve, që është jashtëzakonisht e qartë dhe konkrete. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mustafa, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti Ymeri!

Në procedurë e sipër është në Kuvend Projektligji mbi plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit mbi ndërmarrjet publike. Dhe, ne kemi propozuar që me këtë ligj kombinati “Trepça” të rregullohet me ligj të veçantë. Së pari të bihet strategjia mbi kombinatin “Trepça”, pastaj të bihet ligji mbi “Trepçën”, i cili do të aprovet këtu në Kuvend dhe me të do të përcaktohet edhe karakteri ekonomik edhe karakteri pronësor i “Trepçës”.

Ju e dini se unë e kam tërhequr nga Kuvendi ligjin, me të cilin është propozuar që “Trepça” të shpallet kompani publike. I kam thënë arsyet pse e kam tërhequr dhe, po ashtu mund të theksoj edhe sot, që ne nuk jemi për atë si Qeveri, që “Trepçën” ta shpallim kompani publike. Ne jemi për atë që ky projektligj mbi ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi ndërmarrjet publike të procedohet, të plotësohet dhe ndryshohet, ashtu siç ju deputetë të Kuvendit, e vlerësoni, por që me Ligjin e veçantë për “Trepçën” pastaj të përcaktohet se çfarë do të jetë “Trepça”.

Jam për atë, që të jemi shumë të hapur, të ulemi bashkërisht edhe me opozitën edhe me pozitën, të diskutojmë, të këmbëjmë argumente gjatë hartimit të Ligjit për “Trepçën” dhe të shohim, se cila është mënyra më e mirë, që “Trepçën” ta çojmë përpara dhe që “Trepça” të jetë në shërbim të zhvillimit të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri, a keni pyetje shtesë?

VISAR YMERI: Tash edhe kjo që e thotë sot kryeministri e edhe më herët kur e kemi diskutuar edhe Ligjin për ndërmarrjet publike, është e qartë që qëndrimi, të paktën i tij, e ka mundësi të jetë edhe i Qeverisë, është që “Trepça” të mos bëhet ndërmarrje publike. Pra, që bie ndesh pastaj me kërkesën e minatorëve, të cilën në momentin e ndërprerjes së grevës e keni mirëpritur dhe e keni përshëndetur. Tash, mbase kjo paska qenë vetëm përshëndetje për ndërprerjen e grevës e jo edhe për kërkesën e tyre.

Është e vërtetë që në Ligjin për ndërmarrjet publike aktualisht, në të cilin e kemi në proces në Kuvend, aty në të njëjtin ligj është edhe një nen, i cili thotë që për “Trepçën” do ta kemi një ligj të veçantë dhe një strategji të veçantë. Pra, cili ka qenë qëllimi që të përmendet “Trepça” në Ligjin për ndërmarrjet publike, nëse njëkohësisht “Trepça” nuk do të jetë ndërmarrje publike. Pse është bërë kjo? Është bërë vetëm sa për popullizëm politik apo ka ndonjë arsye tjetër, se unë thjesht, edhe atëherë s’e kam kuptuar dhe vazhdoj të mos e kuptoj?

KRYESUESI: Zoti kryeministër e keni fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Po, mund të them që ndoshta janë dy faktorë, të cilët kanë ndikuar që çështja e “Trepçës” të vihet në kontekstin e Ligjit të ndërmarrjeve publike. Një është sepse e kemi trashëguar një çështje të tillë, ka qenë edhe përpara një propozim, që të rregullohet me këtë dhe e kemi pasur një inercion të trajtimit të tillë. Dhe e dyta, që është më faktike, është që pronat e “Trepçës” mineraret janë pronë publike e Republikës së Kosovës. Ato nuk mund të privatizohen dhe nuk mund t’i marrë askush.

Mbetet vetëm problemi i ndërtesave, pajisjeve, instalimeve të cilat janë mbi tokë, të cilat tani kanë karakterin shoqëror dhe janë nën autoritetin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, por mendoj se pamarre parasysh se si do të jetë vendimi përfundimtar lidhur me “Trepçën” pjesa dërmuese e pronave të “Trepçës” janë prona publike, përpos atyre që janë mbi tokë.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca, pyetje për zëvendëskryeministrin Hashim Thaçi.

GLAUK KONJUFCA: Pyetja ime ka të bëjë me një serë rekomandimesh, që janë miratuar në këtë Kuvend të Republikës së Kosovës, më 1 mars të vitit 2012 dhe, këto rekomandime kanë të bëjnë me ngjarjet e 10 shkurtit të vitit 2007, me ç’rast disa njësi të Policisë së UNMIK-ut kanë shtënë mbi qytetarët paqësorë, të cilët po protestonin në një demonstratë, të thirrur nga Lëvizja “Vetëvendosje”. Dhe, pyetja ka qenë për zëvendëskryeministrin Thaçi, se ai e ka pasur obligim të merret më shumë me këtë punë- Çka ka bërë lidhur me ato rekomandime, të cilat janë miratuar në këtë Kuvend tash e dy vjet dhe e kanë marrë votën e shumicës së grupeve parlamentare, këtu?

Dhe tjetra, kjo do të shihet edhe në dritën e një vendimi shumë të rëndësishëm tash kohëve të fundit, para dhjetë ditësh paneli këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut i UNMIK-ut, që është vetë organ i UNMIK-ut, që merret me monitorimin e sjelljes së policëve të tyre apo të punëtorëve të tyre, që kanë punuar në administratën e UNMIK-ut, e ka marrë vendimin para dhjetë ditësh, një vendim me tri pika, dy prej të cilave janë shumë me rëndësi që UNMIK-u është përgjegjës, ata policë qysh janë sjell atë ditë, janë përgjegjës për mohimin e të së drejtës në jetë

të dy qytetarëve, protestues paqësor; dhe e dyta, që UNMIKU është përgjegjës për pengimin e zhvillimit të demonstratës paqësore nëpërmjet vendosjes së barrikadave dhe pengimit të njerëzve për të marrë pjesë në demonstratë paqësore.

Pra, vetë UNMIK-u e ka marrë këtë vendim, që është një organ i tij paneli këshillëdhënës. Prandaj, të gjithë zyrtarët e Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe kryeministrin dhe zëvendëskryeministrin, duhet të bëjnë më shumë tash në këtë drejtim, sepse tash është shumë më lehtë të kërkohej përgjegjësi, duke qenë se vetë UNMIK-u po e pranon këtë përgjegjësi se çka ka ndodhur atë ditë.

KRYESUESI: Faleminderit! Ju njoftoj se koha është ezauruar, fiks një orë është diskutuar. Nuk keni dashur të vazhdoni, në bazë të kërkesës së kryetarit. Pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare, do të publikohen në Revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit, kurse Zyra për informim e Kuvendit e lëshon një njoftim për media brenda 24 orëve, neni 45, paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit.

Ju njoftoj që për procedurë lidhur me rendin e ditës është paraqitur zoti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë kam një propozim për amendamentim të rendit të ditës të seancës plenare të datës 12 mars të vitit 2015, pra të sotmes, kur në bazë të nenit 42, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, propozoj që të plotësohet rendi i ditës i kësaj seance plenare, në Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Meqenëse, ky ligj i ka kaluar të gjitha komisionet funksionale dhe, ju ka rekomanduar seancës, mendoj që meqenëse edhe nuk ka shumë tema sot, ta fusim dhe ta procedojmë në rend dite gjatë kësaj seance plenare. Nëse deputetë janë dakord, me një votim formal, të japin përkrahjen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konsideroj që ky është mocion në emër të Komisionit në fjalë, po për procedurë, zonja Donika Kadaj-Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, kryesues!

Po ashtu, kam një kërkesë për seancën. Duke iu referuar Rregullores së Kuvendit të Kosovës dhe nenit 63, pika 2, Grupi Parlamentar i Aleancës ka paraqitur në kryesi kërkesën për riorganizim të komisioneve, përkatësisht deputetëve në komisionet parlamentare. E kisha vlerësuar nëse sot do të jetë në pikë të rendit të ditës, në mënyrë që të votohet në seancë dhe të procedojmë më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Është edhe një kërkesë e zotit Topalli.

FATON TOPALLI: Sot sapo morëm lajmin nga kryeministri i Republikës së Kosovës, që ka vendosur ta shkelë vendimin e Gjykatës Kushtetuese për pagesën e parave të punonjësve të Fabrikës së Gypave, prandaj ky është një mashtrim për arsye se vetë Lidhja Demokratike e Kosovës e ka futur Rezolutën, ka bërë Rezolutë. Kryeministri gjatë fushatës zgjedhore i ka takuar punëtorët, u ka premtuar atyre, që do t'u japë paratë, ndërsa tash është mirë që të

diskutojmë dhe të shkojë te punëtorët që janë duke bërë grevë tash dhe t'u thotë, që i ka mashtruar.

Prandaj, i propozoj Kuvendit që të diskutojmë sot edhe për këtë çështje.

KRYESUESI: Faleminderit! Procedurat i dini, zoti Topalli. S'kam asgjë kundër, plotësoni kushtet për ta proceduar sipas rregullave. S'është asgjë e ndaluar për t'u diskutuar.

Zoti Haradinaj, deshe të plotësosh edhe diçka?

DAUT HARADINAJ: Pa injoruar kërkesat e kolegëve deputetë, se me siguri edhe ata i kanë arsyet e veta, unë fola në emër të Komisionit, meqenëse jemi duke folur për ta kompletuar seancën. Dhe, unë mendoj që kjo do të ishte e udhës që ta hedhim në votim propozimin, natyrisht se edhe në emër të Komisionit. I kemi kaluar të gjitha procedurat, i kemi rekomanduar Kryesisë që ta procedojë, në rast se deputetët janë dakord, unë jam i gatshëm për t'ua ofruar ligjin.

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

KRYESUESI: Atëherë, lus regjinë që t'i bjerë ziles, në mënyrë që deputetët të futen në sallë për ta votuar kërkesën e Komisionit, lidhur me futjen në rend të ditës ose shqyrtimin e Projektligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, si pikë e fundit të rendit të ditës.

E dini, që për t'u futur në rend të ditës, duhet të votohet nga 2/3-at e deputetëve të pranishëm.

A dëshirojnë shefat e grupeve parlamentare që të deklarohen? Jo. Atëherë, zonja Bala, uluni në vend, sepse është votimi. A deshe Adem, të flasësh?

Mendoj që në njëfarë mënyre jeni të gjithë dakord, që ta fusim në rend të ditës, por sidoqoftë, lus... Zoti Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Zoti kryesues,

Absolutisht unë pajtohem me kërkesën e zotit Haradinaj. Është një ligj që është shumë i rëndësishëm që të ec më tutje, por deputetët, ne jemi të organizuar në grupe parlamentare dhe është në interes të votimit dhe të qartësimit, që të deklarohen shefat e grupeve parlamentare dhe gjithsecili veç e veç t'u bëjë thirrje deputetëve për të votuar.

Prandaj, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike i japim përkrahje dhe u bëjmë thirrje të gjithëve që të votojnë.

KRYESUESI: Nga Grupi Parlamentar i LDK-së, zonja Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah iniciativën, kërkesën për shmangie nga Rregullorja dhe futje në rend të ditës Projektligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Mendojmë që kushtet janë të plotësuara, duke pasur parasysh që të gjitha komisionet e përhershme, përveç Komisionit funksional e kanë dhënë dritën e gjelbër, prandaj, në emër të grupit të LDK-së e përkrahim këtë shmangie dhe futjen në rend të ditës dhe i ftoj deputetët që të votojnë.

KRYESUESI: Faleminderit! Përfaqësuesit e grupeve të tjera nuk janë paraqitur. Atëherë, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Sa i përket këtij projektligji, ne kemi thënë fjalën tonë edhe në leximin e parë edhe gjatë punës tonë në komisione edhe kemi parashtruar amendamentet të cilat për shkaqe dhe arsye procedurale nuk janë futur në shtyllat e amendamenteve. Nuk kemi asgjë kundër që ky të procedohet, por ajo çfarë ne kërkojmë, të dimë tani a do ta procedojmë, a po bisedojmë tani për procedurë, a po bisedojmë tani, sepse më sa dëgjova dy përfaqësuesit paraprakë, duket se nuk e kanë të qartë nëse jemi duke biseduar tash duke kërkuar mbështetjen për procedurë për ta futur në rend dite, apo mbështetjen për votim të ligjit, për shkak se nuk ishte fort e qartë.

Nëse jemi tani, pra në fazën që t’u japim deputetëve rekomandimin që ta fusim në rend dite apo jo, kjo është çështje tjetër dhe, kur vijmë në fazën tjetër, që t’u japim rekomandime njerëzve që ta mbështesim apo jo, është çështje tjetër.

Prandaj, do të duhej të sqarohej kjo çështje, se në cilën fazë jemi tani, sepse më duket, se nuk e patën fort të qartë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Selimi. Po, kryetarët e grupeve parlamentare kanë të drejtë, që ta mbështesin ligjin edhe kur të vijë votimi për ligjin, kështu që nuk ka ndonjë shkelje, as nga kryetarët. Po tani, ne do të votojmë për futjen në rend dite të ligjit dhe, pastaj pasi që të diskutohet, kush si do të votojë është çështje e tyre.

Pra, t’i kryej këto çështjet e grupeve parlamentare. Për procedurë, po, Selimi. A je dakord për ta futur në rend dite? Zotit Selimi, fjalën.

REXHEP SELIMI: Nuk e kemi telashe a futet sot në rend dite, apo të futet nesër në rend dite, sido që të vendosë seanca, ne do t’i përmbahemi. Ne kemi gjatë procedimit, pastaj e kemi fjalën tonë.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të AAK-së tashmë është bërë deklarimi. Daut, a dëshiron të flasësh në emër të AAK-së, që je paraqitur. Në rregull, Zoti Haradinaj në emër të AAK-së.

DAUT HARADINAJ: Unë në fillim thashë, a mund të procedoj amendamentimin e seancës dhe mendoj që isha shumë i qartë. Domethënë, për ta kompletuar, për ta futur në rend dite edhe ligjin. Dhe tani, natyrisht se deputeti i “Vetëvendosjes” ka votuar kundër dhe i ka pasur amendamentet, në fillim zoti Topalli, më vonë zoti Selimi, që e kanë të drejtën t’i mbrojnë qëndrimet gjatë diskutimit të neneve.

Por, unë pyetjen konkrete e kam: A mund ta fusim në seancë plenare të ditës së sotme? Kaq.

KRYESUESI: Në rregull! Zonja Mufera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar “6+”.

MYFERA SHINIK: Faleminderit, kryesues! Por, Myfera e jo Mufera! Faleminderit!

KRYESUESI: Më fal!

MYFERA SHINIK: Önerilen Yasa Tasarısının bugünkü gündeme girmesini aynı şekilde “6+” Parlamenter grubu da desteklemektedir. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Zoti Berisha, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Edhe ne si grup parlamentar përkrahim idenë, që sot të trajtohet në lexim të dytë ky ligj dhe, sigurisht që gjatë trajtimit pastaj i kemi edhe disa qëndrime, që do të kërkojmë mirëkuptim nga deputetë, Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani, siç e dini, ne e kemi edhe një votim të fshehtë, që duhet ta bëjmë, por a jeni që ta fusim këtë menjëherë në rend të ditës, apo ta lëmë në fund prapa atij votimit të fshehtë.

Në rregull, atëherë po votojmë të fillojmë me shqyrtimin e ligjit në fjalë të fillojmë menjëherë sipas renditjes, si pikë e katërt e rendit të ditës.

Atëherë, e hedh në votim shqyrtimin e dytë të Projektligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Lus deputetët, që t’i zënë vendet, nëse duan të votojnë. Ju lus që të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Atëherë, ligji u fut në rendin e ditës, si pikë e katërt, me 69 vota për, 1 abstenim dhe 1 kundër.

Besoj që edhe kërkesa e zonjës Kadaj-Bujupi, që t’i themi ndërrimet që janë bërë në kuadër të komisioneve, mund t’i themi tash, pa u futur në shqyrtim të ligjit dhe besoj, që janë të miratueshme.

Grupi Parlamentar i AAK-së ka propozuar zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare, si në vijim:

- Në Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në vend të deputetes Melihate Tërmkolli, propozohet deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

Në Komisionin për Buxhet dhe Financa, në vend të deputetes Donika Kadaj-Bujupi propozohet deputeti Bali Muharremaj.

Në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, në vend të deputetit Blerim Shala, propozohet deputeti Rustem Berisha.

Në Komisionin për Integritet Evropian, në vend të deputetit Blerim Shala, propozohet deputetja Time Kadrijaj.

Të nderuar deputetë, kërkoj nga ju që nëpërmjet një votimi formal, sepse s'besoj se duhet të bëhet votim fare, sepse është e vetëkuptueshme se është qëndrim i grupit parlamentar dhe është e drejtë e tyre që t'i ndërrojnë deputetët.

Pika e tretë e rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Pyes: A keni vërejtje në procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 26 shkurt 2015?

Konstatohet se Kuvendi e miratoi procesverbalin e seancës plenare, të mbajtur më 26 shkurt 2015.

Atëherë, vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndalimin e bashkimit në konfliktet e armatosura jashtë territorit të vendit

Deputetë të nderuar,

Për shqyrtimin e dytë të këtij projektligji, duhet të bëhen shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, ne e kemi bërë atë.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndalimin e bashkimit në konfliktet e armatosura jashtë territorit të vendit dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, pa amendamente.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funksional, zotin Daut Haradinaj, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesues!

Si Komision funksional e kemi shqyrtuar Projektligjin me numër 05/L-02 për ndalimin e bashkimit të konflikteve të armatosura jashtë territorit të vendit dhe pas një diskutimi të thukët, ne edhe si Komision Funksional, i rekomandojmë Kuvendit që ta miratojë në lexim të dytë, pa ndryshime këtë projektligj.

Kisha dashur të theksoj se po ashtu kemi një amendament i cili i ka kaluar të gjitha procedurat nga zoti Zafir Berisha, por pa përkrahjen e Komisionit Funksional, ndërsa për anën procedurale ose për vonesë procedurale, zoti Rexhep Selimi, amendamentet e tij nuk ka mund t'i përfshijë në këtë ligj dhe shpresoj se ai do t'i mbrojë vetë.

Kështu që unë mendoj se ne si Komision i rekomandojmë Kuvendit që ta miratojë ligjin në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani radhën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së nuk dëshiron të flasë askush.

Atëherë nuk është paraqitur kurrkush në emër të grupeve. Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Siç tha edhe kryetari i Komisionit, për shkaqe procedurale, nuk kemi arritur që amendamentet tona të përfshihen në amendamentimet bashkë me Komisionin, por të futet në shtyllën e amendamenteve në raportin e Komisionit, qoftë me përkrahje, qoftë pa përkrahje, por ne kërkojmë që amendamentet tona, vërejtjet tona dhe qëndrimin tonë, ta arsyetojmë me mundësinë që do të më jepej në seancë për t'i lexuar ato amendamente të cilat ne nuk kemi mund t'i përfshijmë për shkaqe procedurale, siç u tha në raportin e Komisionit.

Pra, edhe në leximin e parë ne i kemi dhënë vërejtjet tona dhe duhet ta sqaroj edhe një herë pse ne e kundërshtojmë këtë projektligj të bëhet ligj, për shkak se mendojmë që ky projektligj, respektivisht ky ligj nuk e qartëson dhe nuk e identifikon qëllimin e saktë të tij, i cili i njëjti i jep mundësi që ky ligj të keqpërdoret dhe manipulohet për shkaqe dhe arsye tjera, dhe sidoqoftë për rrethana tjera.

Pra, të theksojmë edhe një herë që Lëvizja “Vetëvendosje”, Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, edhe një herë thekson nevojën për të pasur ligj, por për të pasur ligj të mirëfilltë dhe ligj i cili e përcakton objektivin dhe qëllimin që mund të pretendojë të ketë në këtë rast sponsorizuesi.

Pra, qysh në fillim të këtij projektligji, qysh në titullin e këtij projektligji, ne i kemi identifikuar problemet e këtij ligji dhe kemi amendamentuar problemet e këtij ligji, pra ne i kemi përfshirë dhe shpresoj që të më lejoj seanca që t'i lexojë 8 amendamente që i kam njëherësh, nëse ju dakordoheni, dhe ta shpjegojmë edhe një herë në përputhje me Rregulloren, qëllimin dhe adresimin tonë në kundërshtim të këtij projektligji.

Pra, amendamenti 1, që ne e kemi propozuar, është të ndryshohet emërtimi i projektligjit, nga “Projektligj për ndalimin e bashkimit në konfliktet e armatosura jashtë territorit të Republikës së Kosovës, në këtë rast të vendit”, të themi: “Projektligj për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura ose luftëra të organizuara dhe mbështetura nga organizata apo grupime me aktivitet terrorist”, që i bie nëse doni ta keni një ligj për t'i parandaluar qytetarët e Kosovës, që të marrin pjesë në konflikte si në ISIS, Al Kaida dhe në vende tjera, atëherë identifikojeni sepse është e mundshme që të identifikohet në ligj.

Pra, ky ka qenë dhe është amendamenti ynë, 1.

Amendamenti im i 2, është: Në nenin 2 të Projektligjit të riformulohet me këtë përbërje, pra qëllimi, çfarë qëllimi duhet të ketë ligji.

“Me qëllim të mbrojtjes së interesit shtetëror dhe sigurisë kombëtare, ky ligj përcakton veprën penale të bashkimit apo pjesëmarrjes në konflikte të armatosura ose luftëra të organizuara dhe mbështetura nga organizatat apo grupimet me aktivitet terrorist, të shpallura si të tilla me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës ose nga organizatat ndërkombëtare relevante”.

Edhe në leximin e parë edhe në punën tonë në Komision e kemi bërë të ditur se nëse doni të keni një ligj të vërtet për atë se çfarë thirreni, ky është përshkrimi i duhur në këtë projektligj.

Amendamenti 3. Të fshihet paragrafi 2 i nenit 2 të projektligjit.

Arsyetim: Përfshirja e përgjithshme e cili është përfshirë në paragrafin 2 të nenit 2 të projektligjit aktual krijon një standard të dyfishtë sa i përket përgjegjësisë penale dhe personave që kanë shtetësi të Republikës së Kosovës, në raport me ata të cilët kanë dy shtetësi. Për këtë fshirja e këtij neni është më se e nevojshme për mbrojtjen në parim unik të përgjegjësisë penale sa i përket çështjes së lëndës që e rregullon projektligji.

Amendamenti 4. Të fshihet paragrafi 3 i nenit 2 të këtij projektligji.

Pra, propozuesi konsideron se kjo dispozitë është e panevojshme kur khet parasysh se Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka miratuar ligjin e veçantë me të cilin është rregulluar çështja e pjesëmarrjes së Forcës së Sigurisë, në misionet jashtë vendit.

Pra, nëse ju kujtohet se çfarë thotë ky amendament, thotë se këto dispozita nuk vlejnë për pjesëtarët e FSK-së, nëse ndërrohet titulli atëherë rrjedhimisht edhe pjesëtarët e FSK-së nuk do të duhej të paragjykoreshin se do të mund të jenë mbështetës të aktiviteteve të organizatave terroriste.

Pra, ky është qëllimi i fshirjes dhe jo rastësisht e përmenda.

Të fshihet paragrafi 4 i nenit 3 të këtij projektligji.

Arsyetim: Çështja që ndërlidhet me nxitjen e çfarëdo kryerjeje të veprës penale, është e rregulluar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe për këtë duhet marrë parasysh se Kodi Penal është ligj kryesor material sa i përket sferës penale.

Për këtë propozuesi i amendamentit konsideron se përfshirja e kësaj dispozite në këtë projektligj, është e panevojshme dhe e paarsyeshme në aspektin e doktrinës juridiko-penale.

Amendamenti 6. Pas nenit 4, të shtohet nen i ri me numrin rendor 5, me përmbajtjen si në vijim.

Pra, ne kemi kërkuar që nëse doni të keni vërtet ligj dhe të kemi vërtet një ligj që e arrit qëllimin e këtij ligji, mendoj se do të duhej që brenda këtij ligji të parashtroheshin këto dispozita.

Pra nen i veçantë: “Hartimi dhe shpallja e listës së organizatave, grupimeve dhe individëve me aktivitet terrorist”.

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin penal, aktet ndërkombëtare dhe dokumentet e organizatave ndërkombëtare, duhet të hartojë dhe shpall listën e organizatave, grupimeve me aktivitet terrorist brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

2. Listat e organizatave me cilësim të veprimtarisë terroriste nga paragrafi 1 i këtij neni, do të jenë të bazuara në listën e përditësuar të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe listën autonome të Bashkimit Evropian.

3. Në listën e Qeverisë nga paragrafi 1 i këtij neni, do të jenë të përfshira edhe organizatat e huaja të cilat veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës, pa lejen e autoriteteve dhe të cilat me veprimtaritë e tyre cenojnë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës.

4. Përditësimi i kësaj liste realizohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas nevojës dhe rrethanave, jo më vonë se 30 ditë nga marrja e të dhënave të reja.

5. Mënyra e hartimit dhe procedurat e shpalljes rregullohen me akt normativ të veçantë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe konventat ndërkombëtare të drejtave të njeriut.

Pra, ne kërkojmë që Qeveria të merrte rol në listimin e organizatave dhe personave me aktivitet terrorist.

Amendamenti 7. Pas nenit 5, të shtohet një nen me këtë përmbajtje, pra neni 6.

Përkufizimi i aktivitetit terrorist në organizatë, grupimi apo individ përcaktohet me ligj të veçantë kundër terrorizmit.

Ne e dimë që kjo është e përfshirë në Kodin e Procedurës Penale, por një ligj i veçantë kundër terrorizmit do të ishte diçka e mirë për arritjen e qëllimeve edhe të këtij ligji.

Dhe, amendamenti 8. Neni 6, të shtohet edhe një nen me këtë përmbajtje: Pra, neni 7 të shtohet në renditje dhe ky është i fundit:

“Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës shpall në njoftim publik listën e personave, që nuk e kemi, shtetas të Kosovës ose me vendbanim ose me leje qëndrimi në Republikën e Kosovës, të kërkuar për veprimtari terroriste. Personat e publikuar në listë do të përfshihen vetëm nëse për këtë vlerësohet nga Prokuroria e shtetit, se hetimet apo ndjekja e personit në fjalë, nuk do të dëmtohet nga publikimi i të dhënave personale”.

Pra, këto kanë qenë vërejtjet tona, të përfshira në amendamente, të cilat edhe u theksuan këtu dhe për shkak procedurale nuk kemi mund t’i përfshijmë, që do ta bënin vërtet një ligj.

Pra, i bie: Nëse doni të keni ligj për çka thirrëni, ligji bëhet kështu. Ligji - projektligji që tani kërkohet të votohet edhe nga Komisioni nuk e arrit qëllimin që ka dhe mbi të gjitha mund të jetë i keqpërdorshëm edhe për shkak juridike, por mbi të gjitha edhe për rrethanat tona ku jetojmë, pra për rrethanat tona dhe për çështjet tona rajonale.

Kështu që mendojmë që thërrasim Kuvendin, deputetët e Kuvendit, që t’ia kthejnë Qeverisë këtë projektligj që ta bëjnë një ligj ashtu siç duhet dhe qëllimet e saj t’i ketë të përshkruara në projektligj që do ta mbështetnim. Pra ne do ta mbështesim një projektligj i cili vërtet do ta kishte të përshkruar qartë, ashtu siç e parashtrova këtu, qëllimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sidoqoftë, ne dhe ju e dini që e drejta për të bërë amendamente është e rregulluar me Rregulloren, por edhe pas miratimit të ligjit dhe nënshkrimit, e drejta për të kërkuar riamendamentim të ligjit është e gjithë neve, prandaj meqenëse për fajin e juaj, do të thosha, sipas informacioneve që i kam në letra, jeni vonuar dhe Komisioni s'ë ka marrë parasysh.

Ne i dëgjuam, dhe nëse ka ndokush vërejtje nga grupet parlamentare ose mendon se vërtet duhet ndryshuar diçka, foltorja është e hapur për të gjithë dhe votimi do ta tregojë se çfarë duhet të bëjmë.

Fjalën e ka kërkuar Fadil Demaku.

FADIL DEMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Realisht tash s'ka pasur nevojë ta marr fjalën mbasi projektligji i ka kaluar të gjitha procedurat, por më nxiti fjala e zotit Selimi. Ne do të jemi të qartë edhe me të gjithë deputetët këtu në seancë, ne në Komision e kemi diskutuar këtë projektligj pothuaj se në tri mbledhje vazhdimisht dhe të gjitha amendamentet të cilat na i prezantoi zoti Selimi, kanë qenë në të tri mbledhjet e Komisionit, janë diskutuar nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Fillimisht kanë ardhur në emër të zotit Topalli e pastaj në Komision ato nuk e kanë marrë aprovimin prej asnjë anëtarëve tjerë të Komisionit, pastaj është kyçur zoti Selimi dhe dua të sqaroj këtu se nuk ka pasur çështje procedurale. Unë mendoj që është një strategji e tyre që të bëjnë politikë tash këtu në seancë përpara opinionit të gjerë, sepse të gjitha mundësitë në mbledhjen e Komisionit i kanë pasur, që të futen të gjitha këto amendamente në kuadër të projektligjit dhe jo t'i lexonte tash në këtë formë. Nuk ka pasur çështje procedurale që s'ka mundur, por është bërë në mënyrë të qëllimshme për ta bërë një politikë të caktuar tash me opinionin.

Çështjet të cilat i ngriti në amendamente, zoti Selimi, anëtarët e komisionit të gjithë kanë vlerësuar se nuk kanë të bëjnë me natyrën e këtij projektligji dhe nuk e kanë marrë përkrahjen e anëtarëve të tjerë të Komisionit.

Kjo është çështja dhe nuk pati fare nevojë që të lexohen ato përpara seancës tash këtu.

KRYESUESI: E drejta e secilit deputet, prej 120 është të diskutojë krejt çka dëshirojnë lidhur me ligjin. Unë s'mund t'ia marr fjalën askujt sa i përket asaj që dëshiron të diskutojë për ligjin, për të tjerat pastaj është tjetër gjë,

Zoti Selimi, replikë!

REXHEP SELIMI: Faleminderit, kryesues!

Nuk do të doja që t'i jap natyrë replike kësaj, por dua të sqaroj diçka. Unë askënd nuk e fajësova që i ka shkelur procedurat dhe sot ne nuk i kemi këto amendamente të përfshira në raportin e Komisionit.

Pra, as Komisionin as sekretarinë e Kuvendit, por e theksova edhe një herë, për shkak të mospërcjelljes së procedurave, ne nuk kemi arritur që t'i përfshijmë këto.

Unë po ashtu kam shpresuar që do ta kemi të mundshme që këto amendamente të përfshihen edhe në seancë në leximin e dytë, duke u thirrur në praktikën e përdorur në këtë Kuvend, për shkak se ka pasur praktika ku janë përfshirë amendamente të caktuara në lexim të dytë gjatë seancës.

Gjatë konsultimit tim me sekretarinë e kam vërejtur se kjo nuk është brenda rregullave, por është një praktikë. Unë nuk desha të thirrem në praktika, prandaj e respektova Rregulloren dhe nuk e fajësova askënd sa i përket procedurave, pra, pikërisht, e mora vet përgjegjësinë që nuk kam mund t'i përcjell procedurat krejt për shkaqe objektive, dhe kjo dihet tashmë.

Po dua të them edhe një gjë tjetër, sa i përket diskutimit, sa i përket përmbajtjes, nuk do të doja që kolegët e mi të ma kontestonin përmbajtjen në këtë formë duke i dhënë konotacion politik, për shkak se pikërisht kjo përmbajtje e adreson, e saktëson edhe më shumë qëllimin nëse sponsorizuesi paska pasur t'i parandalojë qytetarët e Kosovës të marrin pjesë në Siri. Por, nëse e keni luftë kundër terrorizmit, kështu bëhet, nëse doni ta keni një ligj që do ta përdorni për arsye tjera, bëhet ashtu siç keni bërë ju kështu. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Demaku.

FADIL DEMA KU: Faleminderit, nënkryetar!

As unë nuk e kam në kuptimin e replikës e kundër-replikës, por më tepër për sqarim.

Nuk ishte fjala ime më përpara në atë që t'i ndalohet fjala dikujt, absolutisht, sepse debati është gjëja më normale për deputetët të cilët diskutojnë këtu, por unë e sqarova një çështje, që u lexuan amendamentet në emër të mos mundësisë së tyre për shkak të procedurave dhe unë e sqarova se nuk ishte çështja aty.

Sa i përket çështjes së debatit, jemi të hapur dhe unë me atë pikë pajtohem, por ishte më tepër për të sqaruar seancën dhe opinionin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Demaku! Fjalën e ka zonja Donika Kada j-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah projektligjin.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Qela e ka fjalën.

RAIF QELA: Nuk do të ndalesha te përmbajtja e këtij ligji – projektligji, meqenëse siç po duket edhe ashtu shumica e grupeve parlamentare do të votojnë për.

Do të ndalem vetëm në gabimet drejtshkrimore dhe në një fjalë që nuk është fjalë shqipe dhe që mund të zëvendësohet me fjalë shqipe.

Përdoret fjala “trajnim”, e cila nuk është fjalë shqipe dhe e cila mund të zëvendësohet me fjalën e barasvlerëshme shqipe - “stërvitje”. Me “stërvitje” përmbli dhet krejt ajo çka është dashur të arrihet me këtë projektligj.

Prandaj, meqenëse është problem vetëm i gjuhës dhe jo i përmbajtjes, ju propozoj që në vend të fjalës “trajnim” të zëvendësohet me fjalën “stërvitje”.

Ndërsa, për gabimet drejtshkimore, besoj se do t’i eliminojë me kohë lektori, megjithatë unë kam parë plot ligje në të cilat ka plot gabime drejtshkimore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Shpresoj se vërejtjet tuaja i ka dëgjuar Administrata. Fjalën e ka zoti Haradinaj edhe një herë, apo e ke shtypur gabimisht.

DAUT HARADINAJ: Desha të ndërlihem me deputetin Selimi. Kurrjë të keqe nuk ka që u lexuan amendamentet apo propozim amendamentet e “Vetëvendosjes”, por megjithatë, sa për sqarim të opinionit publik se ky ligj në formën e njëjtë e ka marrë besimin e deputetëve në legjislaturën e kaluar. Po ashtu i ka kaluar të gjitha procedurat, në të gjitha komisionet funksionale ku edhe vetë zoti Selimi ka qenë anëtar i atij Komisioni.

Të njëjtat procedura tash jemi detyruar edhe një herë t’i kthejmë prej fillimit, i kemi kaluar dhe mendoj se edhe në votim, edhe në diskutime kur janë bërë propozimet e amendamenteve, është lejuar edhe kjo e sodit. Nuk pati gjë të keqe, sepse të paktën është për informim të opinionit.

Megjithatë, përmbajtja e ligjit është parandalimi i njerëzve për t’iu bashkuar organizatave të ndryshme potencialisht terroriste.

Mendoj se nuk është ligj më i miri në botë, por në këto rrethana është e domosdoshme ta marrë besimin e deputetëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Po e shoh reagimin e deputetëve, por kjo është çështje procedurale dhe unë kam të drejtë. Nëse e shkeli procedurën, është kujdestari këtu lart - sipër.

(Ndërhyrje)

Dakord. Faleminderit! U tha që në legjislaturën e kaluar e kemi përkrahur apo s’e kemi përkrahur, ne të njëjtat vërejtje i kemi pasur në legjislaturën e kaluar. Theksoj, të njëjtat vërejtje. Mund t’i referohemi edhe seancës në lexim të parë në legjislaturën e kaluar, mund t’i referohemi edhe komisioneve, por duhet t’ua rikujtoj kolegëve të mi që- a do ta përdorni analogjinë e njëjtë edhe për Tribunalin? Sepse, Grupi i Aleancës, në legjislaturën e kaluar e ka mbështetur Tribunalin, kurse në këtë legjislaturë ka ndryshuar qëndrim.

Pra, a do ta merrja si jokonsistencë qëndrimin tuaj? Kështu që po them edhe një herë se qëndrimi ynë edhe në legjislaturën e kaluar, edhe në këtë legjislacion është pikërisht i njëjti, është pikërisht e njëjta temë dhe të njëjtat vërejtje. Po ashtu, edhe i njëjti qëndrim.

KRYESUESI: Zoti Haradinaj, kundër-replikë.

DAUT HARADINAJ: Të them sinqerisht, i mbarmi njeri që më kishte shkuar mendja në këtë sallë është Rexhep Selimi për t'i replikuar, dhe jashtëzakonisht po më çudit.

Megjithatë, sa për freskime të memories së zotit Selimi, kam votuar kundër Tribunalit, këtu në këtë sallë dhe do të votoj prapë kundër, por do ta informoj zotin Selimi edhe opinionin publik se në Komisionin e kaluar, në legjislaturën e kaluar, deputeti Rexhep Selimi, ka abstenuar. Nuk ka votuar kundër. Dhe për këtë, me mi dhënë 5 minuta, shkojmë e marrin transkriptin dhe i tregoj se kush i ndërron qëndrimet.

Domethënë, ke abstenuar në Komisionin e kaluar dhe e kam kontrolluar, e kam parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Topalli, i fundit është paraqitur.

FATON TOPALLI: Faleminderit, për fjalën!

Jam shumë i shqetësuar për mënyrën qysh po diskutojmë për ligjet, për nenet e caktuara, e kështu me radhë.

Mendoj se në kuptimin e vlerave, të gjithë ne po pajtohemi, edhe me Qeverinë, se jemi për luftë kundër terrorizmit.

Edhe ne si Lëvizje “Vetëvendosje” jemi kundër terrorizmit dhe kemi bërë pikërisht amendamentet të cilat përcaktojnë se ky është qëndrimi ynë.

Jemi kundër shkuarjes në vendet ku luftohet, jemi kundër Al Kaidës, kundër ISIS-it, të gjitha këto i kemi theksuar.

Ajo që këtu po duket është se më duket nuk e keni lexuar ligjin mirë dhe nuk i keni dëgjuar fare vërejtjet tona.

Dallimi mes propozimit që ka ardhur prej Qeverisë dhe propozimit që ka ardhur prej nesh, qëndron në faktin se ligji i Qeverisë është një ligj kundër luftërave. Në përgjithësi kundër luftërave, nuk e përcakton se kush është terrorizmi, ku luftohet dhe si luftohet terrorizmi.

Ne e kemi bërë një propozim i cili është shumë specifik, i cili përcakton qartë se çka do të luftohet, si do të luftohet dhe është një orientim i mirë për qytetarët.

Ajo që po shihet këtu është që edhe Qeveria, edhe deputetët e kanë plot gojën kompromis, e kanë plot gojën bashkëpunim, e kanë plot gojën - hajde i bëjmë gjërat bashkë, por në fakt, kur të vjen çështja për çështjet që janë shumë konkrete, ku ne e kemi mendim të njëjtë sa i përket vlerave, atëherë po duket qartë se këtu është fjala vetëm për të dominuar, për arsye se ky Kuvend, kjo Qeveri e ka shumicën e numrave, por nuk ka fare të drejtë dhe ligjin të cilin e ka propozuar Qeveria, është shumë, shumë më i keq se sa ligji që e kemi propozuar ne.

Prandaj, amendamentet tona janë shumë konkrete, amendamentet tona e përcaktojnë qartë kush është terrorizmi, amendamentet tona kërkojnë që të zbatohen praktikatat e ndryshme perëndimore,

qofshin të Gjermanisë, qofshin të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, qofshin të Zvicrës. Pra, ne i kemi propozuar praktikat të cilat janë perëndimore.

Ju po thoni, ja ku është mali, e aty ka terroristë, ne po themi jo, nuk po themi mali, por po themi ja ku janë terroristët, po i emërojmë saktësisht të cilët ata, dhe ju jeni kundër.

KRYESUESI: Në rregull! Fjalën e ka zonja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

E mora fjalën meqë edhe në këtë projektligj po diskutohen shumë çështje për të bërë fushatë politike.

Seanca ka filluar sot dhe qytetarët më së paku kanë nevojë që ne t'i përfaqësojmë ata, të shohin edhe një herë që edhe Kuvendi nuk po e kryen punën si duhet.

Le që Qeveria nuk është kah e kryen aspak, sot i ka bërë 3 muaj ditë dhe nuk e kemi edhe një vendim i cili sadopak kishte për ta ndryshuar gjendjen e qytetarëve në vend.

Prandaj, ju lutem deputetë dhe deputete, në politikë duhet të ketë parime, por të paktën parime njerëzore dhe morale.

Andaj, unë trishtohem që të gjitha ato femra të cilat na shikojnë neve sot, edhe meshkuj, që ne nuk do të jemi të përjetshëm, shohin se aq pak parime kanë mbetur sot. Prandaj ju lutem të kemi parime njerëzore dhe të mos tjetërsohemi për momentin apo edhe për subjektet politike.

Andaj, ta bëjmë përfaqësimin ashtu siç neve na e kanë dhënë besimin qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Ilir Deda është paraqitur për diskutim.

ILIR DEDA: Faleminderit!

Unë iu kisha drejtuar grupeve parlamentare të PDK-së dhe LDK-së.

Duke marrë parasysh se ekziston praktika parlamentare e shqyrtimit të amendamenteve si këtë që po e kërkojmë ne, është në interes të vendit dhe është në interes nacional, dhe është në interes të gjithë neve që ligji kundër terrorizmit të votohet unanimisht në Kosovë, nga deputetët në Kuvend.

Dhe unë ju kisha lutur që ta shqyrtoni dhe që ta zbatojmë këtë praktikë parlamentare edhe në rastin e 9 amendamenteve që i ka dorëzuar apo cilat dëshiron t'i dorëzojë Lëvizja "Vetëvendosje".

Mendoj se nuk prish punë nëse e shtyjmë një apo dy orë për votimin në këtë projektligj që të informohen 120 deputetë për amendamentet të cilat ne i kemi propozuar dhe të votohen.

Këto amendamente e bëjnë ligjin më të mirë dhe këto amendamente janë në përputhje të plotë me praktikën më të mirë të shteteve anëtare të BE-së dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ju lutem, kështu që të mos bëjmë të shtyhem këtu kush është kundër terrorizmit më shumë.

Unë edhe një herë apeloj që të zbatohet kjo praktikë, një praktikë e mirë parlamentare edhe në këtë rast. Faleminderit !

KRYETARI: Faleminderit! Unë në rend të parë dëshiroj ta falënderoj Komisionin përkatës dhe të gjithë anëtarët e Komisionit përkatës që e kanë dhënë këtë kontribut dhe na kanë dhënë mundësinë sot të procedojmë, për arsye se të gjithë jemi për të njëjtën çështje, por të vazhdojmë të procedojmë.

E ka një unanimitet, ky është mesazhi çfarë ne si deputetë dhe Kosova e dërgon për këtë ligj, ka unanimitet të gjitha partive politike dhe grupeve parlamentare, por nuk ka unanimitet për disa çështje të cilat janë më tepër terciare, do të kisha theksuar, kjo, se nuk janë primare ato që po diskutohen.

Deputeti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Vetëm sa për procedurë kur do ta marrësh fjalimin kishte qenë mirë për të dalë në foltore dhe zakonisht, kryetarët...

KRYETARI: Vërejtje me vend. Do ta bëj. Faleminderit, kërkoj falje!

ARBEN GASHI: Atëherë, sa i përket komenteve edhe të kolegut Deda, mendoj se unë jam i bindur se qëllimi është i mirë i zotit Deda, por kemi një problem logjik.

E para, nuk bëhet fjalë për Ligjin kundër terrorizmit, por bëhet fjalë për Ligjin për parandalimin e pjesëmarrje në konfliktet e huaja.

Dhe e dyta, nuk po e kuptoj pse edhe në Komision kam pyetur, pse nuk kanë hyrë në procedurë, pse nuk i kanë dorëzuar proceduralisht këto amendamente?

Dhe, e treta, ka të bëjë me një element jashtëzakonisht të qenësishëm. Unë jam i bindur që “Vetëvendosja” e ka vullnetin e mirë, por këto amendamente janë goxha shumë dhe ndikojnë goxha shumë në tërë tërësinë e ligjit, kështu që pa kaluar edhe nëpër komisione funksionale, është problematike, se ne për gjysmë ore ose një orë t’i kryejmë amendamentet dhe t’i përfshijmë.

Kështu që, unë nuk e kam kuptuar sinqerisht pse “Vetëvendosje” nuk i ka proceduar në mënyrë formale dhe sot do të ishim të detyruar si deputetë të japim vlerësim me votë ose vlerësim me diskutim për amendamentet e Lëvizjes “Vetëvendosje”, kështu që këtu është problemi procedural edhe teknik.

Dhe në fund, mendoj se ne duhet ta kemi këtë ligj dhe po shihet se ka vullnet për të pasur këtë ligj, por po më vjen keq që ndoshta janë vonuar pak “Vetëvendosja”. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, Ilir Deda!

ILIR DEDA: Faleminderit!

Arben, nëse ka vullnet të mirë, mbliidhet komisioni për gjysmë ore dhe i shqyrton amendamentet. Ama, kjo ka të bëjë me vullnetin e mirë në anën tuaj, te Lidhja Demokratike dhe te Partia Demokratike.

Në mandat të legjislaturës së pestë ka ndodhur e njëjta, kur kanë shkuar amendamentet gjatë seancës gjatë pauzës, kurse unë edhe një herë po apeloj, në qoftë se ekziston vullneti i mirë për t’u zbatuar praktikrat e mira parlamentare, ju lutemi edhe në këtë rast me 9 amendamentet e Lëvizjes “Vetëvendosje” të zbatohet e njëjta.

KRYETARI: Kundër-replikë, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Vetëm një sqarim për zotin Deda, demokracia është edhe procedurë. Dhe proceduralisht është e pamundshme për t’i shtirë në rend dite, sepse vetëm seanca mund të vendosë nëse do t’i shtijë në rend dite tash, por procedura për propozimin e amendamenteve ka kaluar dhe mesa po e kuptoj unë për këtë arsye nuk kanë mund të hyjnë amendamentet e Lëvizjes “Vetëvendosje” sepse nuk janë respektuar afatet kohore për dorëzimin e amendamenteve. Pra, nëse ka ndonjë arsye tjetër, ju lutem ma sqaroni! Faleminderit!

KRYETARI: Rexhep Selimi, e dëshiron fjalën?

REXHEP SELIMI: Të gjitha këto amendamente i kam paraqitur në Komision. E kam kuptuar që nuk ia kam arritur, edhe një herë për të tretën herë e theksoj, nuk ia kam arritur për çështje procedurale t’i fus këto në shtyllën e raportit, për shkaqe vonese, për shkaqe afatesh. Nuk i kam përcjell afatet, kam kërkuar nga Komisioni dhe e kemi shqyrtuar këto në Komision.

Po ashtu kam shpresuar në praktikrat e këtij Parlamenti që ka ndodhur kështu edhe me projektbuxhetin, në këtë legjislaturë, edhe në legjislaturën e kaluar janë futur amendamente gjatë seancës në lexim të dytë dhe unë kam kërkuar dhe kam shpresuar që kjo seancë mund t’i aplikojë këto praktika për të gjithë, jo njëanshëm. Prandaj, sot këto amendamente i kam sjell këtu në lexim të dytë për t’i prezantuar para deputetëve dhe deputetët t’i shqyrtojnë.

Nëse ju e keni të nevojshme t’i dini se kush janë këto amendamente, për shkak se dëgjova nga disa deputetë - se sot nuk i keni, ju i keni pasur përfaqësuesit tuaj dhe i keni përfaqësuesit tuaj në komision, por unë mund ta bëj një gjë të tillë, me 5 minuta kohë mund t’ia shpërndajë secilit nëpër tavolina tuaja dhe ju mund t’i shihni.

Pra, nëse thirrreni në vullnet të mirë, nëse doni vullnet të mirë, unë mund t’ua sjell secilit prej jush këto amendamente në tavolinë dhe t’i shqyrtoni. Dhe kur j u t’i shqyrtoni, po flas për ata që s’i kanë parë, sepse shumica i ka parë, atëherë mund ta bëj një gjë të tillë.

Pra, nëse thirreni në vullnet të mirë, ju mund të aplikoni këtë vullnet të mirë. Nëse thirreni në praktika parlamentare, pra flas me praktika, ju mund t'i zbatoni këto për të gjithë jo në mënyrë selektive, për shkak se theksoj edhe një herë këto praktika janë zbatuar në këtë Parlament, edhe në këtë legjislaturë edhe në legjislaturën e kaluar. Prandaj, nëse ju vlerësoni, unë mund t'i kopjoj dhe t'ua jap secilit veç e veç.

KRYETARI: Arben, veç shkurt, sepse se e shkeli Rregulloren, dhe ti si ekspert i Rregullores e di se e shkeli. Urdhëro, por të lutem shkurt!

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Vetëm sa për të sqaruar. Me sa po kuptoj unë, zoti Selimi po propozon mocion përmbajtësor, a të futet në rend dite propozimi i tyre për amendamente apo jo. Dhe ajo duhet të hidhet në votim, përndryshe nuk ka mundësi kështu, ju lutem, definoni kërkesën. Nëse kërkesën e definoni si mocion përmbajtësor, atëherë seanca është e obliguar ta hedhë në votim mocionin a do ta pranojë apo jo, përndryshe s'mund ta shti në rend dite. Faleminderit!

KRYETARI: Glauk Konjufca, urdhëroni!

GLAUK KONJUFCA: Qysh do që të jetë, në emër të "Vetëvendosjes" po flas. Atëherë, nëse doni kështu të formulohet konkretisht, propozimi ynë konkret është - kërkojmë mocion, pra për t'u hedhur në votim çështja që këto amendamente kaq të rëndësishme të votohen dhe deputetët të pozicionohen karshi kësaj që po kërkojmë ne.

KRYETARI: Lus deputetët të mos largohen. Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Nuk e di çka ka të paqartë rreth këtyre procedurave. Faktikisht e tha shumë mirë dhe e sqaroi Fadil Demaku se këto amendamente na kanë ardhur tri herë në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe të Mbikëqyrjes së FSK-së. Një herë kanë ardhur të adresuara në emër të Faton Topallit, të cilat amendamente nuk ka qenë në gjendje as vetë Rexhep Selimi t'i mbrojë dhe ka kërkuar për seancën tjetër të Komisionit, të shtyhen. E kemi mirëkuptuar dhe i ka prurë në seancën tjetër të Komisionit. Prapë i kemi shqyrtuar dhe kemi marrë vendim, thjeshtë si Komision, nuk kanë kaluar në Komision.

Është çështje e tyre në Grupin Parlamentar pse janë vonuar proceduralisht dhe ka ardhur situata këtu ku ka ardhur. Dhe, unë mendoj se nuk kemi asnjë arsye pse na sot ta shtyjme për pas dy ore, apo pas pesë minutave që t'i bëjmë propozime e rekomandime tjera seancës.

Mocionin, si e qartësoj Arbeni, është shumë në rregull nëse e kërkojnë ata dhe vendos seanca, që është dashur me kohë të bëhet mocioni, e jo i gjithë ky muhabet.

Tjetra, çka desha të them, u përmend disa herë këtu sot se po bëhet politikë. Mua më kënaq për vete situata kur bëhet politikë në Kuvend, sepse fatkeqësisht në shumicën e rasteve e kemi zhvendosur politikën, e kemi qitur në nivel të kafesë. Faleminderit!

KRYETARI: Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Realisht, edhe Kuvendi po pajtohet që është një ligj, ligj i rëndësisë së veçantë, por, duhet të jemi shumë korrekt në procedurat e Kuvendit, që nga miratimi i një projektligji dhe deri në miratimin final, aty ku mbërrin te ju për nënshkrim.

Ky ligj, apo ky projektligj, i ka vetëm 5 nene dhe ju e dini se nëse një ligj ndryshohet më shumë se 40% edhe për nga përmbajtja, atëherë paraqet një projektligj tërësisht të ri.

Në Rregulloren e punës së Kuvendit dhe në hartimin e legjislacionit dhe e dimë se nuk jemi kah bëjmë ligj për herë të parë, plus janë vonesat kohore. Më i shkathtë Zafiri se sa një subjekt i juaji politik. Domethënë ky paska pas arritur një amendament ta paraqesë, e ju komplet, një subjekt politik s'keni mund prej 23 janarit t'i zini afatet. Dhe tash për 5 minuta të vendosë Kuvendi për një përmbajtje, tërësisht të re, për një ligj që e lufton terrorizimin ose Kosova bëhet partner i luftës kundër terrorizmit.

Është pak e padrejtë, edhe në aspektin procedural, qoftë edhe ajo përmbajtjesore dhe politik. Për hir të korrektesisë, ju mund të kërkonit lexim të tretë të ligjit, ose bartjen në një lexim të tretë dhe atëherë Kuvendi mund të vendosë a e çon në lexim të tretë a jo, dhe ato 8 amendamente të bëhen pjesës përmbajtjesore e këtij projektligji.

KRYETARI: Atëherë, Glauk Konjufca edhe një herë.

GLAUK KONJUFCA: Unë mendoj që të gjitha diskutimet që erdhën prej deputetëve që i takojnë pozitës, e shmangën thelbin e problemit për të cilin po diskutojmë. Këtu po diskutohet që deputetët më në fund të pozicionohen karshi këtyre amendamenteve, jo që ta japin votën e tyre pro apo kundër menjëherë, por që këto të hyjnë e të diskutohen në këtë seancë apo jo.

Të gjitha ato që e keni mendjen t'i thoni nëpërmjet kësaj propagande që po e bëni, mund shumë lehtë ta bëni nëpërmjet këtyre sustave që ekziston për, abstenim apo kundër.

S'kemi nevojë në këtu të merremi tash me këto diskutime, të karakterit partiak, që po i bëni tash, mund të pozicionoheni me votën tuaj. Nëse e keni për praktika parlamentare, atëherë në mund t'ua numërojmë dhjetëra praktika që kanë ndodhur edhe më herët.

E ku është problemi atëherë? Problemi është shumë i thjeshtë! A jeni që këto amendamente të hedhen në votim, apo jo? Nëse jo, ju lutem mos harxhoni kohë duke biseduar po e keni sustën atje dhe votoni ju. S'po di pse po e ndërlikoni këtë problem.

KRYETARI: I kisha lutur deputetët që të qëndrojnë në sallë pasi jemi afër votimit. Shkojmë në mënyrë formale, së pari shefat e grupeve parlamentare.

E ka bërë një propozim Grupi Parlamentar i "Vetëvendosjes" për çështjen e mocionit, a jeni për ta proceduar apo jo, sepse ju i përfaqësoni deputetët.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, urdhëroni!

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryesues!

Shikoni, ne duhet ta kemi parasysh, nëse është vonuar pak Grupi Parlamentar i “Vetëvendosjes”, nuk i kanë kaluar ato procedurat e rregullta. Si do qoftë, Grupi Parlamentar i PDK-së vlerëson se mund të merren dhe jemi dakord të merren në konsideratë e të kalojnë në lexim, ndërsa, gjithsecili deputet voton sipas vlerësimit të vet të lirë.

KRYETARI: Zoti Grabovci, a ka mundësi në emër të Grupit Parlamentar një qëndrim pak më të qartë.

A jeni për mocionin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”?

Kjo na merr një kohë pak më të gjatë, duhet të futen ato në procedim, duhet të futen në votim, apo jeni për të vazhduar? Tash, për të votuar, e kemi një amendament të Zafir Berishës. Urdhëro, Adem Grabovci.

DEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë vlerësoj se bëra përpjekje të jem i qartë dhe të jem shumë më i qartë. Grupi Parlamentar i përkrah që të futen në lexim ato amendamente.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Dëshiroj të deklarojmë me këtë rast. Në fakt, Rregullorja e punës së Kuvendit, në mënyrë të saktë tregon se si bëhet leximi i parë, si bëhet amendamentimi, si shkon në lexim të dytë dhe në rast nevojë të shkojë në lexim të tretë, për të cilin kemi pasur edhe raste kur ka shkuar në lexim të tretë.

Është shumë e pakuptimtë që një grup i madh parlamentar nuk ka arritur të dërgojë amendamente për një afat dymujor, që do të thotë për një afat i cili është i përcaktuar, qoftë edhe dy ditë. Kjo është e para, do të thotë, shkelja e Rregullores.

E dyta, është në një ligj prej 5 neneve po propozohet që të ketë edhe 9 amendamente.

E treta, në qoftë se ne hyjmë në analizën e këtij projektligji, nuk kemi nevojë që në fillim të projektligjit të lexohen 9 amendamente, të cilat unë nuk i di çfarë janë dhe asnjëherë nuk kam pasur rast t’i shoh. Besoj se shumica e deputetëve as nuk kanë pasur rast që t’i shohin, përveç se të dëgjojnë, dhe 9 përmendsh nuk i mbajnë në mend.

Dhe e fundit, është zoti kryetar, që kur të hyjmë në amendamentim të këtij ligji dhe votimin e ligjit, secili deputet, mundet në amendamentin, në nenin e përcaktuar të amendamentit mund ta paraqesë mendimin e vet.

Domethënë, ekzistojnë mënyrat ose të ndërpritet, të shkojë, të procedohet, vjen në Kuvend, të shkojë në Komisionin funksional, t’i kalojë edhe katër komisione tjera, por procedura tjetër e rregullt është që kur hyjmë në leximin e dytë, në pika ku janë amendamentet, të diskutohet konkretisht për nen dhe amendamente. Mendoj se edhe kjo është një prej procedurave.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

(Ndërprerje)

KRYETARI: Nga Grupi Parlamentar i “Nismës”, fjalën e ka Zafir Berisha.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, zoti kryetar!

Meqë nuk ishit prej fillimit, po mendoj se u bë një lapsus. Insistimi i juaj që dy herë për të kërkuar prej Ademit, qëndrim, ishte që a është duke ditur Ademi çka është duke folur?

Jo, por u kuptua, meqë Ademi nuk është duke ditur çka është duke folur, ne patëm një mocion për të hyrë në rend dite kjo dhe u qit në votim, e tash kërkohet mocioni i dytë.

Unë mendoj se në këtë rast PDK-ja s’është e interesuar të kalojë ky ligj dhe le të dalin e të thonë s’jemi për këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Vetëm pak. Shumë i qartë ishte deputeti dhe e falënderoj se ma thjeshtësoj mua qëndrimin publik, për arsye se nuk ka qëndrim dhe realisht – konfuzion. Deri sa ju flisni, 5-6 deputetë tuaj më kërkojnë falje si ekspertë tuaj. Grupi 6+, ju lutem.

ĆERIM BAJRAMI: Poštovani predsedavajući,

S obzirom da sam i ja član Komisije za unutrašnje poslove i da sam učestvovao redovno, dakle u donošenju ovoga zakona i njegovom slanju ovde na Parlamentu na drugo glasanje, mogu da kažem samo da na Komisiji nismo imali dakle većinsko slaganje da se ovaj amandament prosledi u Skupštini.

U ovom slučaju mi ćemo dakle prihvatiti većinsku odluku, s obzirom da želimo da pokažemo kolegijalnost i ako većinska odluka ide na to da se čitaju amendamenti, onda u redu. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit ! Patëm qëndrimet e grupeve parlamentare. Po e shoh se është ora 13,30 dhe të shkojmë në pauzë dhe në orën 15 do të vazhdojmë seancën parlamentare. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Jemi në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit

Deputetë të nderuar,

Do të procedojmë tani me votimin e propozimit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për votimin e amendamenteve të propozuara nga deputeti Rexhep Selimi, pas afatit të paraparë me Rregullore.

Për miratimin e këtij propozimi duhet të bëhet shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, nga neni 57, paragrafi 3.

Për t’iu shmangur Rregullores, Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm në mbledhjen plenare.

E kisha lutur regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim!

Ju lutem, regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Deputetë të nderuar,

E kisha lutur regjinë të thërrasë deputetët për të ardhur në seancë, sepse na duhet kuorumi i nevojshëm i votave.

Atëherë, e provojmë edhe një herë! E lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se në votim morën pjesë 66 deputetë, për votuan 17 deputetë, kundër votuan 42 deputetë dhe kemi 7 abstenime.

Nuk miratohet propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për votimin e amendamenteve të propozuara nga deputeti Rexhep Selimi, pas afatit të paraparë me Rregullore.

Vazhdojmë me shqyrtimin e dytë të Projektligjit për ndalimin e bashkimit në konfliktet e armatosura jashtë territorit të vendit.

Në këtë projektligj, Komisioni FunkSIONAL nuk ka propozuar amendamente. Një amendament është propozuar nga deputeti Zafir Berisha, pa përkrahje nga Komisioni FunkSIONAL.

Urdhëroni zoti Zafir, fjala është për ju.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar!

Në fakt, kjo çështje u diskutua disa herë në komision dhe thënë të drejtën, në takimin e fundit para se të vijmë në seancë dhe kur kemi rekomanduar për të ardhur në seancë ka qenë pak më ndryshe, por si do që të jetë unë mendoj se te neni 1, ku flitet për qëllimin e ligjit, mendoj që të shtohet edhe pasusi në këtë nen, ku nga organizatat ndërkombëtare, si OKB-ja, NATO dhe Bashkimi Evropian, si dhe Qeveria e Kosovës, luftërat të cilët cilësohen okupuese, ose aktivitete terroriste, konflikte e caktuara në botë, këtë pasues në këtë nen ka menduar, jo për ta gjetur mesin midis këmbëngulësisë të arsyeshme të “Vetëvendosjes” dhe të iniciuesit të këtij ligji, por si do që të jetë mendoj se duhet pasur parasysh situatën e shqiptarëve në rajon, të kaluarën e afërt historike... Më fal, jem duke folur, kur të ju vijë radha mund të flitni edhe ju.

Kështu që unë kërkoj një mirëkuptim nga deputetët dhe të përkrahet kjo ide për arsye që besoj të gjithë i dinë edhe pa i sqaruar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Në lidhje me këtë amendament të zotit Berisha, mendoj që është goxha problematik, sepse asnjë nga këta organizma ndërkombëtarë, si OKB-ja, NATO-ja, BE-ja e tjerë nuk shpallin luftëra që nuk ua vënë emrin luftërave të ndryshme që mund të zhvillohen në botë, sepse kjo është shumë relative, nuk nxjerrin asnjë dokument e ne s'mund t'i referohemi.

Për shembull, një luftë mund të konsiderohet nga gjysma e shteteve të OKB-së okupuese, ndërsa nga gjysma tjetër si luftë çliruese. Rasti më emblematic është vetë rasti i Kosovës, kur shumë shtete ndërhyjnë për ta çliruar Kosovën, ndërsa shtete të tjera sot e kësaj dite e konsiderojnë ndërhyrje në sovranitetin e ish-Jugosllavisë. Kështu që mendoj që ky amendament nuk e ka vendin këtu, sepse krijon probleme të shumta.

Sa i përket listës së organizatave terroriste, edhe kjo nuk është e rregulluar. Për shembull OKB-ja i ka vetëm dy organizata të shpallura si terroriste, ndërsa shtetet të tjera për shembull të BE-së sipas shteteve e kanë të shpallur listën e organizatave terroriste dhe për më tepër lista e organizatave terroriste duhet të shpallet nga Qeveria. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni, zoti Zafir!

ZAFIR BERISHA: Thënë të drejtën, unë nuk e shpjegova me qëllim, sepse e dija që dikush do të reagojë. Kushtetuta e vendit u referohet këtyre mekanizmave ndërkombëtarë dhe unë prita se cili deputet do të reagojë për të kuptuar diçka që edhe ata e dinë që po reagojnë, çka unë desha ta kuptoj.

Në fakt, në mbledhjen e fundit, për të mos gabuar, anëtarët e komisionit janë këtu, madje edhe vetë kryetari i tij.

Unë kam insistuar që shprehjet OKB, BE dhe NATO të hiqen dhe të mbetet vetëm Qeveria e Kosovës. Mirëpo, nuk e di pse kësaj është proceduar deri në këtë seancë, apo është procedua për të ardhur në shprehje pastaj njerëz të tillë siç e bëri zonja Lama dhe të votohet kundër ky mendim imi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë me votimin e amendamentit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Për amendamentin e Zafir Berishës, votojmë tash!

Atëherë, kanë votuar 63 deputetë, kurse 42 janë kundër, prandaj nuk kalon amendamenti.

Të nderuar deputetë,

E votojmë në tërësi tekstin e Projektligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votimin e projektligjit. Votojmë tash!

Konstatohet se në votim morën pjesë 79 deputetë, për votuan 60 deputetë, kundër votuan 17 deputetë dhe abstenuan 2 deputetë.

Konstatohet se Kuvendi e miratoi Ligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Po urdhëroni, i nderuar deputet!

(Reagime nga salla)

Lus Administratën ta ketë parasysh megjithatë. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2015

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Jemi në radhën e diskutuesve.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Naser Osmani, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Urdhëroni, zoti deputet!

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, në pajtim me nenin 2.1 të Ligjit numër 04/L-168 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-101 për Fondin Pensional të Kosovës e ka proceduar në Kuvend kërkesën për miratimin e taksës vjetore për vitin 2015, përkatësisht për miratimin e taksës investive dhe taksës operacionale.

Fondi i Kursimeve Pensionale ka filluar në vitin 2015 me një miliard e 87 milionë euro të mjeteve në menaxhim dhe ka paraparë që deri në fund të vitit të menaxhojë rreth një miliard e 158 milionë euro, që domethënë që brenda vitit të ketë rritje të mjeteve edhe për 71 milionë.

Kthimi në investime është paraparë të jetë 36 milionë e 230 mijë euro, që është 3% e mjeteve të këtij viti.

Kontributet e arkëtuara do të jenë 130 milionë euro për këtë vit. Ndërkaq tërheqjet e kursimeve si rezultat i pensioneve do të arrijnë shumë prej 18 milionë euro.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 27.2.2015, pasi e shqyrtoi kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksës vjetore për vitin 2015, e analizoi buxhetin e Fondit të miratuar nga Bordi udhëheqës. Bëri vërejtjet në buxhetin e planifikuar nga Fondi për Shpenzime Operacionale dhe suficitin e akumuluar nga aktivitetet investuese të planifikuara për ta mbuluar pjesën e shpenzimeve investive të pafinancuara nga taksa investive e propozuar.

Fondi e ka dorëzuar kërkesën me ndryshime në shpenzimet e planifikuara operacionale sipas kërkesës së komisionit, respektivisht në heqjen në tërësi të disa pozicioneve, siç janë: sigurimi fiduciar, shujta, si dhe zvogëlimi i disa kategorive tjera të shpenzimeve operacionale, si shpenzime që kanë të bëjnë me Bordin Drejtues në shumë prej 46 mijë e 300 euro. Është fjala për shpenzime që kanë të bëjë me akomodime dhe transportin.

Komisioni nuk e ka pranuar kërkesën e Fondit që të bëjë rritjen në shumë prej 49 mijë euro për kompensimin e anëtarëve të Bordit. Dua ta theksoj këtë dhe kjo duhet të jetë në vendim që komisioni nuk ka pranuar rritjen e shtesës për anëtarët e Bordit.

Po ashtu, ka bërë zvogëlime në shumë prej 29 mijë e 300 euro për shpenzimet e Personelit. Shpenzimet profesionale janë zvogëluar për 8 700 euro, shërbimet e operimit të zyrës për 3 500 euro, marrëdhëniet me publikun dhe korrespondencën janë zvogëluar për 10 mijë e 960 euro.

Në total, buxheti operacional është zvogëluar për 138 mijë e 840 euro nga kërkesa e parë e Fondit.

Me këto ndryshime, buxheti operacional është propozuar për 10,2% më i ulët se në vitin e kaluar. Ndërkaq taksa operacionale, e propozuar në vitin 2015, është për 0,045% më e ulët se në vitin e kaluar.

Të ju rikujtoj se vitin e kaluar taksa operacionale ka qenë 0,13%. Taksa investive është propozuar prej 0,40%, që është në përqindje të njëjtë si në vitin e kaluar. Duke theksuar se shpenzimet investive janë të lidhura me kosto që i ngarkojnë menaxhuesit e fondeve investive, apo aset-menaxherët nëpërmjet të cilëve fondi investon mjetet pensionale.

Me gjithë faktin që mjetet janë rritur në menaxhim nga viti i kaluar, taksa investive është propozuar të jetë e njëjtë. Por, në faktin se janë shtuar menaxhues të rinj të mjeteve me qëllim të diversifikimit të riskut dhe mbrojtjes më të madhe të mjeteve në rast të rënies të tregjeve financiare, taksa përsëri ka mbetur menaxhuese e njëjtë.

Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit ta miratojë taksën operacionale prej 0,085% dhe taksën investive prej 0,40%. Njëkohësisht, Komisioni rekomandon që Fondi i Kursimeve Pensionale, suficitin e akumuluar nga aktivitetet investuese në shumë prej 87 000 euro ta kthejë në llogarinë individuale të kontribuuesve pensionalë të Kosovës.

Komisioni me të drejtë ka kërkuar që Fondi nuk mund ta mbajë suficitin e akumuluar siç është arsyetuar, me qëllim që Bordi Drejtues ta ketë fleksibilitetin për manovrimin strategjik për investimin e mjeteve, pasi me nenin 2, paragrafi 2 i Ligjit nr. 04/L-168 për ndryshimin dhe

plotësimin e Ligjit 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës, është e paraparë që në rast nevojë, si rezultat i aktiviteteve financiare dhe lëvizjeve të çmimeve në treg, Kuvendi mund ta miratojë taksën investive shtesë në bazë të propozimit të Fondit, e cila duhet të jetë e specifikuar dhe e arsyetuar për aktivitetet investive.

Të nderuar deputetë,

Ju keni parë që në momentin e fundit ju është ndërruar rekomandimi për arsye se është bërë një lëshim nga komisioni që taksa e shpenzimeve operationale ka qenë e prezantuar te ju me 0,087, e është dashur të jetë ashtu siç e keni tani të korrigjuar me 0,085. Këto janë mjete të domosdoshme për të mundur Fondi të operojë me këtë potencial financiar, të cilin e ka në tregjet financiare ndërkombëtare.

Nuk kemi lejuar rritjen e pagës për anëtarët e Bordit dhe ky nivel i pagave të tyre është nga viti 2002. Kemi në konsideratë krejt sukseset e arritura deri më tash të këtij menaxhmenti dhe të këtij Bordi, veçanërisht meqë ka një rritje nga investimet nga viti në vit. Vitin e kaluar dhe këtë vit parashihet të ketë rritje, përsëri konsideroj që çështja e pagave nuk është kompetencë e komisionit, por duhet të jetë me ligje të veçanta që e rregullojnë këtë çështje.

Unë vetëm mund t'ju bëj ftesë që në emër të komisionit ta përkrahni këtë koeficient të taksës menaxhuese për këtë institucion, i cili nuk është i madh në krahasim me kërkesat e tyre, por është një taksë e cila është edhe më e ulët se vitin e kaluar. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, e dëshiron dikush fjalën? Zonja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale dhe ka ardhur në përfundim që t'i miratojë rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah rekomandimin për zbritjen prej 10% të taksës operationale krahasuar me vitin 2014, si dhe e përkrah rekomandimin që suficiti i vitit të kaluar të kthehet në llogaritë individuale të kontribuuesve të Fondit të Kursimeve Pensionale.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike kërkon nga Fondi i Kursimeve Pensioneve që në raportin vjetor të paraqesë në mënyrë më të detajuar shpenzimet operationale dhe mënyrën e pagesës së aset-menaxherëve nëpërmjet Fondit të taksës investive.

Në materialin që na është ofruar nga Fondi i Kursimeve Pensionale vërehet se ka një stabilitet në saje të stabilitetit që ka mbizotëruar në tregjet financiare ndërkombëtare. Fondi i Kursimeve Pensionale e ka pasur një performansë pozitive, meqë e kemi pasur një kthim bruto prej 67 milionë euro, ose 6,3% të mjeteve të investuara. Megjithatë, Fondi i Kursimeve Pensionale duhet të jetë më transparent ndaj Kuvendit, prandaj në raportin në të cilin duhet ta dorëzoj në Kuvend

duhet t'i paraqesë në mënyrë më të detajuar çështjet që janë me interes për Kuvendin dhe me interes për kontribuesit në këtë fond.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka përkrahur taksën operationale dhe taksën inventive dhe rekomandon që të votohet rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Metaj e ka fjalën.

BARDHYL METAJ: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës me kujdes të veçantë dhe me një debat shterues e ka shqyrtuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për taksën vjetore menaxhuese, si dhe atë për investime dhe shpenzime operationale.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke pasur parasysh sukseset e viteve të fundit të këtij Fondi, si dhe trendët pozitivë të ngritjes të fitimeve të Fondit të Kursimeve Pensionale, ta zëmë për vitin 2012 +54,2 milionë , pastaj për vitin 2013 mbi 71,1 milionë, kurse në vitin 2014 mbi 66,8 milionë, konsideron se Bordi i këtij Fondi e ka bërë një punë të mirë dhe të suksesshme dhe për këtë e përgëzojmë Bordin dhe kryetarin e tij.

Rrjedhimisht, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që të aprovet taksa e propozuar investive në masën 0,40%, si dhe taksa për shpenzime operationale tashmë e zvogëluar në 0,085 %. Gjithashtu, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah vendimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që shuma prej 870 000 euro, e mbetur aty si rezultat i suficitit të akumuluar të vitit të kaluar, të mos përdoret nga Fondi Pensional për shpenzime operationale e çështje tjera, por të derdhet në fondin e kontributdhënësve.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës kërkon me këtë rast nga kryeministri i Kosovës dhe Kabineti qeveritar që konform paralajmërimeve të tyre programore ta sjellin sa më parë Ligjin për pagat e zyrtarëve të lartë, në mënyrë që të eliminohen anomalitë që po ngjajnë gjithandej në institucionet e shtetit, si dhe në bordet e ndryshme, ku ngjanë që drejtorë të ndryshëm të kenë paga pesëfish apo gjashtëfish më të mëdha se të krerëve të shtetit dhe të bosëve të kompanive shumë të mëdha private. Pra, anomali të cilat për vite me të drejtë janë shënuar nga qytetarët e Kosovës si qasje absurde dhe e paqëndrueshme e trajtimit të parasë publike për paga marramendëse.

Nga Bordi i Fondit Pensional, ndërkaq, kërkojmë që në një kohë shumë të shkurtër të bëjë një analizë të pagave në Fondin Pensional, veçanërisht të ekzekutivit e menaxhmentit dhe stafit profesional me sektorin përkatës financiar, si dhe t'ia dorëzojë shumë shpejt brenda muajit Komisionit për Buxhet dhe Financa një pasqyrë krahasuese të pagave të tyre me organizatat e ngjashme të rajonit. Gjithsesi, kur flasim për pagat në këtë Fond të rëndësisë së veçantë, ne konsiderojmë se duhet gjithherë ta kemi parasysh edhe profilin specifik të kësaj organizate, në

menaxhimin e së cilës kërkohen përgatitje, dije dhe shkathtësi shumë specifike të tregjeve financiare globale.

Në anën tjetër, duke pasur parasysh se Fondi menaxhon me paratë e qytetarëve kontributdhënës, ne si Lidhje Demokratike e Kosovës kërkojmë një transparencë maksimale, jo vetëm rreth politikave të Fondit, por transparencë totale dhe maksimale edhe në politikën e pagave, në mënyrë që të evitohen të gjitha spekulimet dhe përfoljet e mundshme.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës propozon që të aprovohet kërkesa e Fondit të Pensionistëve të Kosovës, si dhe rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, përfshirë edhe vërejtjet tona. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojë rekomandimin e komisionit karshi kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale, veçanërisht rekomandimin e dytë, i cili kërkon nga Fondi që ta kthejë suficitin e akumuluar në llogaritë e qytetarëve të Kosovës, ose qytetarëve të Kosovës që kontribuojnë në Fondin Pensional.

Mendoj se ulja e taksës si përqindje, taksat racionale dhe ajo investive, nuk do të thoshte asgjë po të mos ulej edhe buxheti i gjithmbarshëm, pra po të mos reduktohej edhe buxheti i gjithmbarshëm, veçanërisht ai operativ i Fondit të Kursimeve Pensionale për shkak që natyrisht kjo përqindja që i aplikohet shumë së tërësishme nën menaxhim, edhe nëse ulet nuk nënkupton që rezulton domosdoshmerisht në para më pak, sepse ky Fond shkon vazhdimisht duke u rritur. Mirëpo, në letrat që i kemi përpara, që i ka dorëzuar Fondi i Kursimeve Pensionale, shihet se edhe buxhetin e ka reduktuar karshi rritjes së efijencës aty dhe shpenzime më të pakta për punën që kryhet aty.

Po ashtu, jemi plotësisht dakord me kërkesën dhe moslejimin që ia ka bërë komisioni rritjes së të ardhurave për anëtarët e Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale dhe pajtohemi me kërkesat e deputetëve që të kemi një kujdes të shtuar në politikën e pagave, qoftë të Bordit apo të punëtorëve të tjerë aty, menaxhmentit do të kisha thënë të Fondit të Kursimeve Pensionale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Ymeri! Fjalën e ka zonja Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Po ashtu, për të mos e përsëritur çfarë thanë kolegët, pajtohemi me rekomandimet e komisionit dhe konsiderojmë që është për t’u përshëndetur fakti që krahas rritjes së performansës të këtij Fondi, ka pasur edhe kursime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “Nisma”, fjalën e ka zoti Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit kryesues!

Po ashtu, Grupi Parlamentar “Nisma për Kosovën” e mbështet në tërësi përshkrimin që e bëri kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe ne do ta përkrahim rekomandimin që ka ardhur nga ai komision. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Damka në emër të Grupit Parlamentar “6+” .

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim Sayın Meclis Başkan vekili. “6+” Parlamenter grubu da Bütçe ve Finans Komisyonu önerisini desteklemektedir. Yıllık ayrılacak olan payının olması gerektiği konusundayız, fakat benden önce konuşan arkadaş milletvekillerin dediği gibi emekli fonundaki çalışanların maaşlarını gözden geçirilmesi gerekmektedir. Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit! Nga deputetët, zonja Lama është paraqitur.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Nuk do të merrem shumë me detajet në lidhje me rekomandimet e komisionit, por natyrisht këtu nuk mund të lëmë pa e përmendur një fakt me shumë rëndësi që lidhet me mënyrën se si këta zotërinj që e drejtojnë Fondin e Kursimeve Pensionale i kanë menaxhuar ato para.

Prej fillimit, Fondi i Kursimeve Pensionale po sillet si qeveri më vete, si qeveri e pavarur brenda shtetit të Kosovës. Ata u bënë vite në fakt që abuzojnë me pensionet e qytetarëve të Kosovës, duke i caktuar vetes paga tepër të larta, për shembull sa dyfishi i pagës së kryeministrit të Kosovës, madje edhe benificione të tjera. Këto para duhet sqaruar që merren nga shuma që qytetarët e Kosovës derdhen në këtë Fond Pensional.

Drejtori gjeneral, për shembull, paguhet 5 200 euro në muaj, e që është e barabartë me pagat e 5 ministrave të Qeverisë të Kosovës. Po kështu, paga e drejtorit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës është shumë e madhe edhe në raport me pagat e drejtuesve të tjerë të institucioneve të rëndësishme të pavarura në vend.

Përveç pagës, sikur nuk u mjaftojnë pagat jashtëzakonisht të larta, zotërinjtë që e drejtojnë këtë institucion nuk përtojnë ta qerasin veten me lloj-lloj beneficioneesh për të cilat mediat kanë raportuar, për shembull që kanë shkuar deri në 12 000 euro. Janë pagesa për punë jashtë orarit të punës, bonuse e benificione të tjera, që asnjëherë nuk janë specifikuar në raportet financiare që i vijnë Kuvendit të Kosovës.

Unë mendoj që Kuvendi i Kosovës duhet të kërkojë raporte shumë të detajuara për mënyrën se si po menaxhohen këto para, paratë pra që ia dedikojnë vetes këta që e drejtojnë Fondin e Kursimeve Pensionale, e po kështu duhet të kemi raporte të analistëve në lidhje me suksesin e operimit të këtij Fondi në tregjet ndërkombëtare financiare. Nuk mjafton të thuash që ka qenë i suksesshëm, por kjo duhet bazuar në analiza dhe ekspertizë. Sa për sukses, para dy-tre vjetësh e di se ky fond i ka humbur 100 milionë euro në kohën e krizës, kështu që nuk mendoj që ne duhet të votojmë verbër dhe t’i plotësojmë kërkesat e tyre, por çfarëdolloj vendimi që marrim në lidhje me këtë Fond, duhet të shoqërohet edhe me kërkesë llogarie.

Deri tani mendoj që Kuvendi ka dështuar për ta bërë një gjë të tillë, përderisa vazhdohet të vepron në të njëjtën mënyrë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani nuk ka tjerë të paraqitur për diskutim. Mendoj që edhe diskutimin e zonjës Lama duhet pasur parasysh, sidoqoftë unë e hedh në votim propozimin për shqyrtimin e kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2015.

Lus regjinë dhe juve kolegë dhe kolege që të përgatiteni për votim. Votojmë tash!

Regjia, nuk e kemi plotësuar numrin e duhur. Ju lus të uleni në vendet tuaja dhe të votoni, se në qoftë se nuk plotësohet numri, atëherë nuk quhet i miratuar. Regjia, bjeri ziles, nëse ka deputetë jashtë le të futen brenda.

Edhe një herë e përsëritim votimin. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Në rregull! Atëherë konstatoj që me 60 vota për, 4 abstenime, asnjë kundër, Kuvendi e miratoi kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2015 dhe rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që suficiti i akumuluar t'u kthehet në llogarinë individuale kontribuuesve në Fondin e Kursimeve Pensionale.

Ju lus të mos dilni nga salla, se është një votim i domosdoshëm, prandaj të jemi të gjithë këtu në Parlament.

Nënkryetari i Kuvendit, nga radhët e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, ka dhënë dorëheqje. Dorëheqja mendoj që meqenëse është edhe vendim i grupit, prapë mendoj se duhet të votohet t'i pranohet në Parlament dhe pastaj kemi votimin tjetër për zgjedhjen e kandidatit të propozuar nga Lëvizja “Vetëvendosje”, zonja Aida Dërguti, për të qenë anëtare e Kryesisë. Ju e dini se duhet të jenë të paktën 61 vota për, që të zgjidhet anëtare e Kryesisë. Sipas Kushtetutës dhe rregullave që ka vendi, për t'u shkarkuar anëtari i Kryesisë duhet 2/3 e votave të Kuvendit, por meqenëse është dorëheqje personale, mendoj që nuk ka nevojë, por unë besoj që zoti Konjufca, përveç letrës duhet t'i thotë dy fjalë vetë në Parlament, që të mos konsiderohet ndryshe kjo çështje, sepse ka të bëjë me Kushtetutën.

GLAUK KONJUFCA: Atëherë, edhe në këtë dokumentin që ia kam dorëzuar Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe Kryesisë dhe kryetarit të Parlamentit, kam shpjeguar pse po e lë këtë detyrë, për arsye se po e marr një detyrë të re, një përgjegjësi të re. Kjo është që nga votimet që kanë bërë deputetët e Lëvizjes “Vetëvendosje” në njërën prej mbledhjeve, jam zgjedhur shef i Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Prandaj, tërhiqem nga të qenit nënkryetar në Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe, kërkojmë që në të njëjtën kohë, të hidhet në votim pika për zgjedhjen e nënkryetares së re të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kurse sa i përket dorëheqjes sime, kjo nuk ma merr mendja që ka nevojë të votohet.

KRYESUESI: Besoj që nuk është dikush kundër dorëheqjes së Glaukut. Nuk ka kundër.

Atëherë, ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, të propozojë kandidatin për nënkryetar të Kuvendit.

GLAUK KONJUFCA: E propozuar për ta marrë detyrën e re të nënkryetares së Kuvendit, në Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” është deputetja Aida Dërguti.

KRYESUESI: Për vëmendjen tuaj, për zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit, sipas nenit 67, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nevojiten shumica e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, pra, së paku 61 vota për.

Në vazhdim, kërkohet deklarimi me votim, për zgjedhjen e zonjës Aida Dërguti, nënkryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga radha e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

(Ndërhyrje)

Edhe një herë po e përsëris, kërkohet deklarimi me votim për zgjedhjen e zonjës Aida Dërguti, nënkryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga radha e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

A ka dikush jashtë që s’është në sallë. Besoj që s’ka. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

(Duartrokitje)

Faleminderit! Atëherë, konstatoj që me 67 vota për, 1 abstenim dhe 1 kundër, deputetja zonja Aida Dërguti, është nënkryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, nga radha e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

7. Zgjedhja e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media

Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, i ka shqyrtuar nominimet e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media dhe Kuvendit i ka paraqitur rekomandimin për miratim.

Ftoj kryetaren e Komisionit ad-hoc, zonjën Xhevahire Izmaqu, që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë rekomandimin.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Fillimisht, para se të lexoj raportin, më lejoni që t’i uroj sukses dhe punë të mbarë zonjës Aida Dërguti, në punën si nënkryetare e Kuvendit. Me të vërtetë “Vetëvendosja” e bëri një punë të mirë, më në fund, propozimin më të mirë brenda këtij mandati. Faleminderit!

Në bazë të neneve 67 dhe 71 të Rregullores së Kuvendit, si dhe nenit 10.5 dhe nenit 11 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media, Komisioni ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, në mbledhjen e mbajtur më 24, 26 shkurt dhe 3 mars, pas

shqyrtimit të biografive dhe intervistimit të kandidatëve të nominuar për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë rekomandim.

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë emërimin e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, me votim të fshehtë.

Për një pozitë të anëtarit të KPM-së, nga radhët e komunitetit serb propozohen për votim dy kandidatët, si në vijim:

1. Milena Gjeriq dhe 2. Jelena Simiq.

Kuvendi bën përzgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media, nga dy të propozuarit.

Për një pozitë të anëtarit të KPM-së nga radhët e komuniteteve tjera propozohen për votim dy kandidatë si në vijim:

1. Sadija Nikshiq dhe 2. Mejdin Saliji.

Arsyetim: Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, pas intervistimit të kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Media, i propozon Kuvendit emërimin e dy anëtarëve të KPM-së.

Anëtarët e KPM-së emërohen nga Kuvendi i Kosovës, në bazë të nenit 13 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media.

Mandati i anëtarëve të KPM-së caktohet me short, tre anëtarë me mandat trevjeçar. Shorti për mandatin e anëtarëve të KPM-së është bërë pas zgjedhjes së pesë anëtarëve të KPM-së në vitin 2004. Pas tërheqjes së shortit për mandatin e anëtarëve të KPM-së kanë mbetur, pra dy pozita për mandat trevjeçar.

Andaj, mandati i dy anëtarëve, që ne sot do t’i zgjedhim, është trevjeçar. Faleminderit! Kaq!

KRYESUESI: Faleminderit! Për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një Komisioni votues, në përbërje nga një deputet prej secilit grup parlamentar, me mbështetje të zyrtarëve të administratës.

Ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare, që të propozojnë nga një anëtar të Komisionit votues. Zoti Grabovci, kë e propozoni ju?

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Dihet, është komision shumë me rëndësi dhe duhet njerëz profesionalë, ne e propozojmë zotin Hajdar Beqa.

KRYESUESI: Hajdar Beqa. Grupi Parlamentar i LDK-së, zonja Sahatqija, kë e propozoni?

TEUTA SAHATQIJA: Grupi Parlamentar i LDK-së e propozon Veton Berishën.

KRYESUESI: Veton Berisha, nga LDK-ja. Lëvizja “Vetëvendosje”?

GLAUK KONJUFCA: Shqipe Pantina.

KRYESUESI: Shqipe Pantina. Grupi Parlamentar i AAK-së?

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Rustem Berishën.

KRYESUESI: Zotin Berisha. Grupi Parlamentar Lista Serbe s’është. “Nisma”?

ZAFIR BERISHA: Enver Hotin.

KRYESUESI: Grupi Parlamentar “6+”?

MYFERA SHINIK: Bu komisyonun daha da profesyonel olması için Kuytim Pacakuyu öneriyoruz.

KRYESUESI: Hajde, Kujtim... Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për formimin e Komisionit votues.

Kundër, ka? Nuk ka! Konstatoj se Kuvendi emëroi anëtarët e Komisionit votues për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

Lus Komisionin që të fillojë me procedimin e votimit, ndërsa deputetët që të ftohen të votojnë sipas listës.

(Ndërprerje e incizimit)

Komisioni, a po e zini vendin e juaj, ju lutem?

(Ndërprerje e incizimit)

Zonja Flora Brovina e ka kërkuar, për arsye personale. Zonja Brovina, doni të votoni?

Adem Grabovci,

(Ndërprerje e incizimit)

Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Fadil Demaku, Milazim Haliti, Azem Syla, Bali Muharremaj, Bekim Haxhiu, Besa Baftija, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Danush Ademi, Faton Topalli, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Duda Balje,...

(Ndërprerje e incizimit.)

...Salihe Mustafa, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoxhaj, Etem Arifi, Fadil Beka, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fisnik Ismajli, Ganimete Musliu, Gëzim Kelmendi, Glauk Konjufca, Shaip Muja, Nait Hasani, Bardhyl Meta, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Synavere Rysa, Ilir Deda, Murat Hoxha, Ismajl Kurtishi...

Ju kisha lutur për pak qetësi, se s'po dëgjojnë deputetët kur po i thërrasim.

...Ismet Beqiri, Enver Hoti, Jasmina Zhivković, Jelena Bontić, Kadri Veseli, Kujtim Paçaku, Agim Kikaj, Labinote Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Latif Gashi, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Fikrim Damka, Margarita Kadriu-Ukelli, Melihate Tërmetkoll, Hajdar Beqa, Mexhide Mjaku-Topalli, Milena Miliçević, Milka Vuletić, Myfera Serbica-Shinik, Muhamet Mustafa, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Raif Qela, Rafet Rama, Ramiz Kelmendi, Ramush Haradinaj, Qerim Bajrami, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Rustem Mustafa, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Sali Morina, Salih Salihu, Sasha Milosavljević, Selviqe Halimi, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyçi, Sllavko Simiq, Slobodan Petrović, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Velimir Rakić, Vetton Berisha, Visar Imeri, Vjosa Osmani, Xhevahire Izmaqi, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

Atëherë, regjia, fjalën komisionit për të raportuar rezultatin e votimit.

VETON BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që para jush t'i thërras emrat të cilët janë votuar nga ju për Komisionin e Pavarur për Media.

Jelena Simiq, Sadija Nikshiq,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Milena Gjeriq, e pa votuar,
Jelena Simiq, Sadija Nikshiq,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Sadija Nikshiq,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Sadija Nikshiq,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, ndërsa te kandidatët e dytë, të dytë janë votuar, e pavlefshme,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,

Jelena Simiq, Sadija Nikshiq,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Sadija Nikshiq,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, për kandidatë të dytë, të dytë janë votuar, e pavlefshme,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji, te kandidatët e parë të dytë janë votuar, e pavlefshme, ndërsa te
kandidati i dytë votohet Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Sadija Nikshiq,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Sadija Nikshiq,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Sadija Nikshiq,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, ndërsa te kandidatët e dytë, janë të dytë të votuar, e pavlefshme,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Sadija Nikshiq,
Jelena Simiq, Sadija Nikshiq,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Sadija Nikshiq,
Jelena Simiq, Sadija Nikshiq,
Kandidatët e parë nuk janë votuar, ndërsa te kandidatët e dytë votohet Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Sadija Nikshiq,
Jelena Simiq, Sadija Nikshiq,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Sadija Nikshiq,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,

Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Kandidatët e parë nuk janë votuar, ndërsa është votuar Sadija Nikshiq, te kandidatët e dytë.
Jelena Simiq, Mejdin Saliji,
Jelena Simiq, Mejdin Saliji, dhe
Jelena Simiq, Mejdin Saliji.
Besoj se komisioni ka arritur t'i numërojë. E ftoj kryetarin e komisionit që t'i japë rezultatet.

KRYESUESI: Regjia, fjalën ia jepni, ju lutem raportueses të komisionit!

SHQIPE PANTINA: Atëherë, Komisioni Votues për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave raporton rezultatet për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

Në bazë të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 të Ligjit numër 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media, dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni votues i formuar me vendim të Kuvendit më 12 mars 2015, në përbërje nga 1 përfaqësues të secilit grup parlamentar:

- Hajdar Beqa, nga Grupi Parlamentar i PDK-së,
- Veton Berisha, nga Grupi Parlamentar i LDK-së,
- Shqipe Pantina, nga Grupi Parlamentar "Vetëvendosje",
- Rrustem Berisha, nga Grupi Parlamentar i AAK-së,
- Enver Hoti, nga Grupi Parlamentar Nisma, dhe
- Kujtim Paçaku, Grupi Parlamentar "6+".

Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e 2 anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, në seancën plenare të mbajtur më 12 mars 2015, konstaton:

- Në votim kanë marrë pjesë 74 deputetë.
- Të pavlefshme nuk ka pasur vota, përveç se 1 votë ka munguar, kanë qenë vetëm 73 fletëvotime në kutinë e votimit.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për një pozitë të anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media, nga radha e komunitetit serb, janë si në vijim:

- Milena Gjeriq, ka fituar vetëm 1 votë,
- Jelena Simiq, ka fituar 66 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për 1 pozitë të anëtarit të Komisionit të Pavarur për Media, nga radhët e komuniteteve tjera, janë si në vijim:

- Sadije Nikshiq ka fituar 18 vota ndërsa
- Mejdin Saliji ka fituar 51 vota.

Në bazë të rezultatit të votimit, në bazë të nenit 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 të Ligjit numër 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se:

- Jelena Simiq, emërohet anëtare e Komisionit të Pavarur për Media, nga radhët e komunitetit serb dhe
- Mejdin Saliji, emërohet anëtar i Komisionit të Pavarur për Media, nga radhët e komuniteteve tjera dhe është i nënshkruar nga anëtarët e Komisionit votues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit prej jush si komision dhe për durimin nga të gjithë deputetët.

Me kaq, seanca e sotme përfundoi. Mirupafshim në seancën e ardhshme!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*